Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Polcenigo*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sopra*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Tramonti Di Sotto*
Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Travesio*
Friuli-Venezia Giulia	Trieste	Muggia*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Attimis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Arta Terme*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Basiliano*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cassacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Cividale Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Chiusaforte*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Comeglians*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Gemona Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paluzza*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ravascletto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Raveo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Premariacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pontebba*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Nimis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Magnano In Riviera*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Malborghetto Valbruna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Moggio Udinese*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Prepotto*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Grimacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Paularo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Pagnacco*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Artegna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Leonardo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	San Daniele Del Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Forgaria Nel Friuli*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Faedis*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Savogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ragogna*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Ovaro*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Taipana*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tricesimo*
Friuli-Venezia Giulia	Udine	Tolmezzo*
Friuli-Venezia Giulia	**Udine**	**Torreano***
Valle d'Aosta	Aosta	Aosta*
Valle d'Aosta	Aosta	Antey-Saint-Andrè*
Valle d'Aosta	Aosta	Arvier*
Valle d'Aosta	Aosta	Arnad*
Valle d'Aosta	Aosta	Ayas*
Valle d'Aosta	Aosta	Aymavilles*
Valle d'Aosta	Aosta	Bard*
Valle d'Aosta	Aosta	Bionaz*
Valle d'Aosta	Aosta	Brissogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Brusson*
Valle d'Aosta	Aosta	Charvensod*
Valle d'Aosta	Aosta	Chambave*
Valle d'Aosta	Aosta	Champorcher*
Valle d'Aosta	Aosta	Chamois*
Valle d'Aosta	Aosta	Chatillon*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Anselme*
Valle d'Aosta	Aosta	Challand-Saint-Victor*
Valle d'Aosta	Aosta	Cogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Courmayeur*
Valle d'Aosta	Aosta	Donnas*
Valle d'Aosta	Aosta	Emarèse*
Valle d'Aosta	Aosta	Fénis*
Valle d'Aosta	Aosta	Fontainemore*
Valle d'Aosta	Aosta	Gignod*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressan*
Valle d'Aosta	Aosta	Gressoney-Saint-Jean*
Valle d'Aosta	Aosta	Hone*
Valle d'Aosta	Aosta	Perloz*
Valle d'Aosta	Aosta	Pont-Saint-Martin*
Valle d'Aosta	Aosta	Pontey*
Valle d'Aosta	Aosta	Pollein*
Valle d'Aosta	Aosta	Roisan*
Valle d'Aosta	Aosta	Rhemes-Saint-Georges*
Valle d'Aosta	Aosta	Nus*
Valle d'Aosta	Aosta	Montjovet*
Valle d'Aosta	Aosta	Morgex*
Valle d'Aosta	Aosta	Issogne*
Valle d'Aosta	Aosta	Issime*
Valle d'Aosta	Aosta	La Salle*
Valle d'Aosta	Aosta	Jovençan*

Valle d'Aosta	Aosta	Lillianes*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Christophe*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Denis*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Marcel*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Nicolas*
Valle d'Aosta	Aosta	Saint-Vincent*
Valle d'Aosta	Aosta	Torgnon*
Valle d'Aosta	Aosta	Quart*
Valle d'Aosta	Aosta	Valpelline*
Valle d'Aosta	Aosta	Valtournenche*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrayes*
Valle d'Aosta	Aosta	Verrès*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *Culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;*

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;*

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore* për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.*

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore,* për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8., 4.9 dhe 4.10 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore,* sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 *të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.*

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve të pikës 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 1024, datë 16.10.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1068, datë 23.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E BELGJIKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Belgjikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Vlaanderen	**West-Vlaanderen**	**Diksmuide***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1069, datë 23.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Brandenburg	Märkisch-Oderland	Neuhardenberg *
Bayern	Dingolfing-Landau	Simbach*
Schleswig-Holstein	Steinburg	Schenefeld*
Mecklenburg-Vorpommern	Rostock	Tessin*
Nordrhein-Westfalen	Paderborn	Delbrück*
Thüringen	Greiz	Zeulenroda-Triebes*
Schleswig-Holstein	Plön	Lütjenburg*
Niedersachsen	Cloppenburg	Garrel*
Niedersachsen	Diepholz	Stuhr*
Brandenburg	Potsdam-Mittelmark	Beetzsee*
Mecklenburg-Vorpommern	Mecklenburgische Seenplatte	Röbel-Müritz*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Greifswald	Torgelow-Ferdinandshof*
Mecklenburg-Vorpommern	Vorpommern-Rügen	Bergen auf Rügen*
Brandenburg	**Oberhavel**	**Kremmen***

Shënim. Simboli (*****) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të

shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1055, datë 22.10.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1070, datë 23.10.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E DANIMARKËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c)shpendëve dekorativë;

ç) materialit biologjik të shpendëve;

d) vezëve të shpendëve;

dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
Veterinary Inspection Unit South	Fredericia*
Veterinary Inspection Unit East	Slagelse*
Veterinary Inspection Unit East	**Sorø***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 2.

7. Urdhri nr. 1045, datë 20.10.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Danimarkës", shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA RARANI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 19017/18)

VENDIM

STRASBURG
14 tetor 2025

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Rarani dhe të tjerë kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh*, president*,
Darian Pavli,
Mateja Đurović*, gjyqtarë*,
dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 19017/18) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") më 13 prill 2018 nga shtatë shtetas shqiptarë, detajet e të cilëve janë dhënë në tabelën bashkëngjitur ("kërkuesit") të përfaqësuar nga z. E. Hicka, avokat i licencuar në Tiranë;

vendimin për të njoftuar për kërkesën Qeverinë e Shqipërisë ("Qeveria") të përfaqësuar nga Agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 23 shtator 2025,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në vitin 1933, paraardhësit e kërkuesve kishin blerë një shtëpi dhe parcelën ngjitur përafërsisht 3 *dynym* (njësia e matjes e përdorur në atë kohë), e cila më pas u shtetëzua nga ish-regjimi komunist në një datë të paspecifikuar.

2. Më 12 dhjetor 1994, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave ("Komisioni") vendosi, mes të tjerave, që t'i kthente familjes K. një pjesë të tokës prej 4.150 m^2.

3. Më 17 prill 1997, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ("gjykata e rrethit") njohu si fakt ligjor të drejtën e pronësisë së trashëguar të kërkuesve, në lidhje me shtëpinë dhe parcelën e tokës *(vendim vërtetim fakti).*

4. Më 30 shtator 1997, Komisioni njohu të drejtat e pronës së trashëguar të kërkuesve në lidhje me tokën të blerë nga paraardhësit e tyre në vitin 1933, me sipërfaqe 3,950 m^2. Nga kjo parcelë, Komisioni i ktheu kërkuesve 2,020 m^2 dhe i kompensoi për 1,930 m^2. Kërkuesit kërkuan edhe 1,244 m^2, por Komisioni nuk e pranoi kërkesën, me arsyetimin që mbivendosej me parcelën që i ishte kthyer tashmë familjes K. (shihni paragrafin 2 më lart).

5. Në vitin 2008, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronës (pasardhëse e Komisionit), rrëzoi kërkesën e kërkuesve për kthimin e parcelës 1,244 m^2, me arsyetimin e mbivendosjes me parcelën e familjes K., sepse vendndodhja e parcelës nuk ishte përcaktuar saktë. Prandaj u shpreh që çështja mund të zgjidhej vetëm nëpërmjet procesit gjyqësor.

6. Në vitin 2008, kërkuesit depozituan një padi civile në Gjykatën e Rrethit ku kërkuan anulimin e vendimit të Komisionit të vitit 1994 në lidhje me njohjen e të drejtave të familjes K. dhe njohjen si pronarë të parcelës prej 1244 m^2. Të paditurit paraqitën kundërpadi me të cilën kërkuan që të njihen si pronarë të parcelës bazuar në parashkrimin fitues. Një raport eksperti i porositur nga Gjykata e Rrethit del në konkluzionin që paraardhësit e kërkuesve kishin të drejta prone mbi një parcelë prej 5,194 m^2, brenda së cilës ndodhej dhe pjesa prej 1,244 m^2. Gjykata e Rrethit gjeti që parcela ishte në pronësi të paraardhësve të kërkuesve që në vitin 1933. Më tej gjeti që parcela tregohej në hartat kadastrale të viteve 1937, 1965, 1971 dhe 1978 dhe që vendimi i Gjykatës së Rrethit i 17 prillit 1997 njihte të drejtën e pronës së trashëguar të kërkuesve mbi atë parcelë. Pavarësisht këtyre gjetjeve, më 27 shtator 2011, Gjykata e Rrethit rrëzoi pretendimin e kërkuesve dhe pranoi kundërpadinë me arsyetimin që familja K. kishte fituar pronësinë përmes parashkrimit fitues.

7. Më 27 qershor Gjykata e Apelit Tiranë ("Gjykata e Apelit") përmbysi vendimin më të fundit të Gjykatës së Rrethit, duke vendosur në favor të kërkuesve me arsyetimin që parashkrimi

fitues në mirëbesim zbatohej vetëm për aktet ligjore, jo për aktet administrative, si në këtë rast. Më 23 korrik 2012, paditësit depozituan një ankim për çështje të ligjit në Gjykatën e Lartë duke pretenduar që përpara shtetëzimit të vitit 1945, prona i përkiste familjes së tyre dhe sidoqoftë ata kishin fituar pronësinë përmes parashkrimit fitues.

8. Më 12 prill 2017, Gjykata e Lartë prishi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe rrëzoi edhe padinë edhe kundërpadinë. Ajo u shpreh, *inter alia* që kërkuesit kishin marrë tashmë njohjen dhe kthimin e pronës së paraardhësve të tyre dhe që parcela e mbetur nuk mund të kthehej sepse nuk ishte në pronësinë e paraardhësve të tyre në momentin e shpronësimit. Gjykata e Lartë u shpreh që gjykatat më të ulëta kishin njohur të drejtën e pronës së paraardhësve të kërkuesve mbi një parcelë toke që përbëhej nga 3 *dynym* dhe shitjen e një pjese të asaj toke. Gjykata e Lartë nuk specifikoi se kur kishte ndodhur shitja e pjesshme dhe për cilën pjesë të parcelës bëhej fjalë, dhe as nuk iu referua ndonjë dokumenti përkatës. Ajo doli në përfundimin që duke njohur pronësinë përtej sipërfaqes 3,950 m^2, Komisioni i kishte dhënë kërkuesve më shumë tokë se ajo që kishin në pronësi paraardhësit e tyre në momentin e shpronësimit, dhe pretendimi i tyre për parcelën prej 1,244 nuk qëndronte.

9. Më 6 tetor 2017, ankimi kushtetues i kërkuesve u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese me arsyetimin që ishte qartazi i pabazuar.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

10. Neni 141 parashikon:

Neni 141

"1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.

B. Kodi i Procedurës Civile ("KPC") në fuqi në kohën përkatëse

11. Pjesa përkatëse parashikon:

Neni 472

Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë, vetëm kur:

a) nuk është respektuar, ose është zbatuar keq ligji;

b) ka shkelje të rënda të normave procedurale;

..."

Neni 485

"Kolegji civil apo kolegjet e bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosin:

a) lënien në fuqi të vendimit;

b) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë;

c) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit, me tjetër trup gjykues;

ç) prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë me tjetër trup gjykues;

d) ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit;

e) prishjen e vendimeve dhe pushimin e gjykimit të çështjes."

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. KOMENTE PARAPRAKE

12. Gjykata vëren në fillim që dy kërkuesit, z. Shaban Rarani dhe znj. Fiqirete Rarani ndërruan jetë në kohën e zhvillimit të procesit gjyqësor (shihni tabelën bashkëngjitur). Trashëgimtarët e tyre shprehën dëshirën për të vijuar procesin përpara Gjykatës. Qeveria nuk kundërshtoi dhe Gjykata vlerësoi që trashëgimtarët e mësipërm kanë interes legjitim për ndjekjen e kërkesës në emër të kërkuesve të ndjerë. Megjithatë, në këtë tekst përsëri do të përmenden kërkuesit (shihni *Horváthová kundër Sllovakisë*, nr. 74456/01, §§ 25–27, 17 maj 2005).

II. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME TË DREJTËN PËR VENDIM GJYQËSOR TË ARSYETUAR

A. Pranueshmëria

13. Qeveria pretendoi që kërkuesit nuk kishin statusin e viktimës dhe që ankimi i tyre ishte abuziv, pa e mbështetur këtë më tej. Gjithashtu, pretendoi që ankimi i kërkuesve ishte me natyrë të shkallës së katërt dhe prandaj i papranueshëm.

14. Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë, në lidhje me statusin viktimë të kërkuesit, dhe kërkesën si abuzive dhe të pambështetur. Gjykata, gjithashtu, vëren që ankimi i kërkuesve ka të bëjë me një të drejtë të mbrojtur nga Konventa dhe që ata ishin të prekur drejtpërdrejt nga rezultati i procesit gjyqësor,

që kishte të bënte me shkelje të dyshuara të së drejtës së pronës dhe të së drejtës për gjykim të drejtë.

15. Për sa i përket pretendimit të Qeverisë që kërkuesit kishin abuzuar me të drejtën e tyre të kërkesës, parimet përkatëse janë përcaktuar, për shembull, në *Gross kundër Zvicrës* ([DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). Synimi i kërkuesit për të mashtruar Gjykatën duhet të provohet gjithmonë me siguri të mjaftueshme (shihni *idem*, § 28). Megjithatë, nuk ka asnjë tregues të tillë në rastin konkret, prandaj ky kundërshtim nga Qeveria, gjithashtu, duhet të rrëzohet.

16. Prandaj, Gjykata konkludon që nuk është i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër dhe duhet të shpallet i pranueshëm.

B. Themeli

17. Kërkuesit u ankuan për procesin gjyqësor përpara Gjykatës së Lartë dhe pretenduan që, në vendimin e saj të 12 prillit 2017, ajo kishte bërë një vlerësim tërësisht të ndryshëm të fakteve krahasuar me atë të gjykatave më të ulëta dhe që ai vlerësim nuk bazohej në provat e paraqitura nga palët. Gjykata e Lartë kishte vënë në diskutim konkluzionet e raportit të ekspertit, ndërsa kërkuesit nuk kishin qenë në gjendje që të paraqisnin ndonjë kundërargument. Ata pretenduan që proceset në Gjykatën e Lartë ishin të padrejta, duke rezultuar në shkelje të paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

18. Qeveria parashtroi që Gjykata e Lartë kishte vlerësuar provat njësoj si gjykatat më të ulëta. Ajo kishte mbështetur faktet ashtu siç ishin përcaktuar nga gjykatat më të ulëta, por e kishte zbatuar ligjin ndryshe, duke dhënë arsyetimin e duhur për prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit.

19. Në lidhje me çështjen e përmbushjes së kërkesave të paragrafit 1 të nenit 6 në këtë çështje, Gjykata vëren se ankimi i kërkuesve për mungesë barazie kishte të bënte në mënyrë specifike me arsyetimin që Gjykata e Lartë kishte bërë në vendimin e saj të 12 prillit 2017.

20. Gjykata, në mënyrë të përsëritur është shprehur që në përgjithësi nuk e ka për detyrë që të shqyrtojë gabime të faktit, apo të ligjit, të pretenduara të kryera nga një gjykatë e brendshme, nëse dhe sa kohë që këto gabime nuk janë të dukshme dhe nuk shkelin të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa (shihni *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 28, GJEDNJ 1999-I; *Perez kundër Francës* [DHM], nr. 47287/99, § 82, GJEDNJ 2004-I; dhe *De Tommaso kundër Italisë* [DHM], nr. 43395/09, § 170, 23 shkurt 2017). Një vendim i brendshëm gjyqësor nuk mund të cilësohet arbitrar aq sa të cenojë drejtësinë e proceseve gjyqësore, nëse për atë nuk janë dhënë arsye ose nëse arsyet e dhëna bazohen në një gabim të dukshëm të faktit ose të ligjit të kryer nga gjykata e brendshme, që ka rezultuar në "mohimin e drejtësisë" (shihni *Ballıktaş Bingöllü kundër Turqisë*, nr. 76730/12, §§ 76-77, 22 qershor 2021, me referenca të mëtejshme).

21. Në këtë çështje, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit dolën në të njëjtat konkluzione për të drejtat e pronës së paraardhësve të kërkuesve mbi parcelën, bazuar në raportin e ekspertit dhe prova të tjera. Ato gjetën që paraardhësit e kërkuesve kishin pasur në pronësi parcelën e tokës prej 1,244 m^2 në momentin e shtetëzimit, pavarësisht qasjeve të ndryshme që ndoqën për rezultatin e kërkesës (shihni paragrafët 6 dhe 7 më lart). Këto gjykata nuk dolën në gjetje për shitjen e pjesshme të pronës nga paraardhësit e kërkuesve.

22. Ndryshe nga këto gjetje, Gjykata e Lartë doli në konkluzionin që kërkuesve iu ishte kthyer më shumë se sa kishin pasur në pronësi paraardhësit e tyre në momentin e shtetëzimit (shihni paragrafin 8 më lart). Faktet e paraqitura në vendimin e Gjykatës së Lartë duket se janë të ndryshme nga ato të përcaktuara nga gjykatat më të ulëta dhe në kundërshtim me provat e paraqitura në çështje. Gjykata e Lartë nuk citon ndonjë provë në mbështetje të konkluzioneve të saj përmbledhëse që paraardhësit e kërkuesve kishin shitur një pjesë të parcelës së tyre fillestare, apo nuk jep ndonjë detaj për datën dhe kushtet e këtij transaksioni (shihni paragrafët 6 dhe 8 më lart). Ndonëse kundërshtarët e kërkuesve në ankimin e tyre për çështje të ligjit kishin pretenduar që kjo shitje kishte ndodhur në një moment të paspecifikuar në kohë, ata nuk paraqitën ndonjë provë për ta mbështetur këtë fakt.

23. Në këtë çështje, Gjykata e Lartë nuk shpjegoi as arsyen pse konkluzionet e raportit të hartuar nga eksperti i caktuar nga gjykata dhe i miratuar nga dy gjykatat e faktit u konsideruan pa rëndësi ose të pasakta, as mbi cilat argumente ajo ishte bazuar për të dalë në një konkluzion të ndryshëm. Sipas Gjykatës, arsyetimi i Gjykatës së Lartë nuk është thjesht një interpretim i ndryshëm i provave, por një përmbysje arbitrare e gjetjeve faktike të gjykatave më të ulëta pa shpjegimet e duhura dhe ndërkohë bazohet në fakte në lidhje me të cilat asnjë nga palët nuk kishte paraqitur prova përpara Gjykatës së Lartë

(krahasoni *Anđelković kundër Serbisë*, nr. 1401/08, § 27, 9 prill 2013).

24. Gjithashtu, në sistemin shqiptar, Gjykata e Lartë më së shumti vepron si gjykatë e çështjeve të ligjit: rekursi në Gjykatën e Lartë mund të jetë depozituar në kohën përkatëse, ku e drejta materiale nuk është respektuar ose është zbatuar gabim nga gjykatat më të ulëta, ose ku kanë ndodhur shkelje të rënda procedurale (shihni paragrafin 11 më lart). Megjithatë, siç theksohet më sipër, në këtë çështje Gjykata e Lartë, pa i vlerësuar konsideratat e rëndësishme ligjore, ka vlerësuar përsëri faktet e përcaktuara më përpara (krahasoni *Sokurenko dhe Strygun kundër Ukrainës*, nr. 29458/04 dhe 29465/04, § 27, 20 korrik 2006).

25. Në këto rrethana, Gjykata veçse mund të dalë në konkluzionin që Gjykata e Lartë nuk ka siguruar, përmes një vendimi të arsyetuar siç duhet, të drejtën e kërkuesve për gjykim të drejtë siç e kërkon neni 6 § 1 i Konventës.

26. Prandaj në këto rrethana konstatohet shkelje e paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

III. SHKELJE TË TJERA TË DYSHUARA SIPAS PRAKTIKËS GJYQËSORE TË MIRËKONSOLIDUAR

27. Kërkuesit, gjithashtu, u ankuan sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës për shkelje të së drejtës së tyre për procese me palë kundërshtare dhe parimit të sigurisë juridike. Ata më tej u ankuan për ndërhyrje në të drejtën e tyre për gëzimin e qetë të pasurisë së tyre, sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

28. Duke pasur parasysh gjetjen e saj në lidhje me të drejtën e kërkuesve për një vendim gjyqësor të arsyetuar sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës (shihni paragrafin 23 më lart), Gjykata thekson se tani kërkuesit kanë mundësi të kërkojnë rihapjen e proceseve përpara gjykatave të brendshme (shihni paragrafin 31 më poshtë). Në parim, kjo mundëson shqyrtimin e ankimeve të mbetura të kërkuesve sipas Konventës përmes një vendimi të mirarsyetuar të Gjykatës së Lartë. Në këto rrethana dhe në përputhje me rolin e saj plotësues, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen ankimet e mbetura të kërkuesve në këtë moment. Për ata është e hapur mundësia që të depozitojnë kërkesë të re në Gjykatë, sipas rastit, pas vendimmarrjes më të fundit për ankimet e tyre në nivel kombëtar.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

29. Kërkuesit pretenduan 1.538.709 euro (EUR) për dëmin pasuror; 15.000 euro (EUR) për dëmin jopasuror dhe 10.000 euro për kosto dhe shpenzime të kryera pranë gjykatave kombëtare dhe Gjykatës.

30. Qeveria gjykon që shumat e pretenduara janë të pabazuara dhe të tepruara.

31. Gjykata përsërit që një vendim gjyqësor ku ajo gjen shkelje të Konventës vendos ndaj Shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të korrigjuar pasojat e saj. Nisur nga natyra e ankimit të kërkuesve dhe e shkeljes së gjetur, Gjykata vlerëson se forma më e përshtatshme e korrigjimit të shkeljes së gjetur do të ishte rihapja e procesit përpara gjykatave të brendshme, nëse e kërkojnë kërkuesit, nisur nga fakti që është në gjendje të sigurojë *restitutio in integrum,* siç e kërkon neni 41 i Konventës (krahasoni *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 maj 2011, dhe *Meli dhe Swinkles kundër Shqipërisë*, nr. 41373/21 dhe 48801/21, § 83, 16 korrik 2024).

32. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore ndërmjet shkeljes së gjetur dhe dëmit pasuror të pretenduar nga kërkuesit. Prandaj ajo e refuzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata vlerëson se kërkuesit duhet të kenë pësuar dëm jopasuror si rezultat i shkeljes së gjetur. Duke e bërë vlerësimin e saj mbi baza të barabarta, siç e kërkon neni 41 i Konventës, ajo i cakton bashkërisht kërkuesve shumën prej 3.600 EUR për dëmin jopasuror.

33. Duke pasur parasysh dokumentet përpara saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që të caktojë shumën 2000 EUR për kostot e proceseve përpara Gjykatës, plus çdo taksë që mund t'u ngarkohet kërkuesve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. Shpall që trashëgimtarët e z Shaban Rarani dhe znj Fiqirete Rarani legjitimohen për të vijuar procesin në vend të tyre.

2. Shpall të pranueshëm ankimin e kërkuesve sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me të drejtën për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

3. Vendos që është shkelur paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës për të drejtën e kërkuesve për një vendim të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

4. Vendos që nuk ka nevojë të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e ankimeve të mbetura.

5. Vendos:

a) që Shteti i paditur t'u paguajë kërkuesve bashkërisht, brenda tre muajve, shumat e mëposhtme, që do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit në fuqi në datën e shlyerjes:

i. 3600 (tre mijë e gjashtëqind euro) për dëmin jopasuror, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet;

ii. 2000 euro (dy mijë euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të ngarkohet;

b) nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje, të paguhet interes i thjeshtë për shumat e mësipërme sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

6. Rrëzon pjesën tjetër të kërkesës së kërkuesve për kompensim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 14 tetor 2025 sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

PRESIDENT
Úna Ní Raifeartaigh

ZËVENDËSKANCELAR NË DETYRË
Olga Chernishova

SHTOJCË

Lista e kërkuesve:
Kërkesa nr. 19017/18

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Shtetësia	Vendi i qëndrimit
1.	Shaban RARANI	1948 Ndërruar jetë në vitin 2022	Shqiptar	Tiranë
2.	Shpresa DINGU	1952	Shqiptar	Tiranë
3.	Fiqirete RARANI	1938 Ndërruar jetë në vitin 2021	Shqiptar	Tiranë
4.	Suzana SENGLA RARANI	1956	Shqiptar	Tiranë
5.	Diana SUÇI	1963	Shqiptar	Tiranë
6.	Elsa SUÇI	1946	Shqiptar	Tiranë
7.	Ilirjan SUÇI	1970	Shqiptar	Tiranë

Trashëgimlënës	Trashëgimtar
Shaban RARANI Ndërruar jetë në vitin 2022	Kimete RARANI Lindur më 1954
	Alba JONUZI Lindur më 1977
	Manuela ABAZAJ Lindur më 1975
	Dorina RARANI Lindur më 1979
Fiqirete RARANI Ndërruar jetë në vitin 2021	Mustafa HYSA Lindur më 1942
	Gëzim HYSA Lindur më 1953

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 51135/22
Minerva KOTHERJA kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 9 shtator 2025, si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar,*
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*
për sa i përket:

kërkesës (nr. 51135/22) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), më 18 tetor 2022, nga një shtetase shqiptare, znj. Minerva Kotherja (kërkuesja), e cila ka lindur në vitin 1951, banon në Elbasan dhe u përfaqësua nga z. E. Kotherja, avokat i cili e praktikon ligjin në Elbasan;

vendimit për të njoftuar mbi ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me sigurinë juridike, qeverinë shqiptare (qeveria), përfaqësuar nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën tjetër të ankesës;

vërejtjet e palëve;

pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë me një mosmarrëveshje për një pronë midis kërkueses dhe palëve të tjera private. Pasi gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë e rrëzuan ankesën e kërkueses, ajo apeloi pranë Gjykatës së Lartë.

2. Më 23 qershor 2016, dhoma e këshillimit në Gjykatën e Lartë, e mbledhur me dyer të mbyllura, e shpalli apelimin e kërkueses mbi pikat e ligjit të pranueshëm dhe e referoi për gjykim.

3. Më 29 maj 2021, hyri në fuqi ligji nr. 44/2021, i cili ndryshoi Kodin e Procedurës Civile (KPC). Ndryshimet përkatëse legjislative i mundësonin Dhomës Civile në Gjykatën e Lartë, të mbledhur me dyer të mbyllura, t'i gjykonte çështjet mbështetur në merita, ndërkohë që përpara këtyre ndryshimeve këto formacione kishin kompetencë të deklaronin të papranueshme vetëm ato apelime mbi pikat e ligjit, që nuk përmbushnin kriteret e KPC-së apo ta referonin një çështje për gjykim të plotë pranë Dhomës Civile të Gjykatës së Lartë. Ndryshimet parashikonin edhe se çështjet pranë Gjykatës së Lartë, si rregull, gjykohen mbështetur në dokumentet në dosje, dhe një seancë publike mbahet vetëm për çështjet që kanë lidhje me unifikimin e praktikës gjyqësore për të dëgjuar palët për shkak të kompleksitetit të çështjes.

4. Më 7 mars 2022, Gjykata e Lartë e anuloi vendimin e saj për të gjykuar çështjen e kërkueses dhe, e mbledhur në një seancë me dyer të mbyllura, e shpalli apelimin e kërkueses të papranueshëm, në mbështetje të nenit 472 të KPC-së. Gjykata e Lartë vlerësoi pikat e ligjit të paraqitura në apelimin e kërkueses dhe konstatoi se gjykata e apelit kishte zbatuar me korrektësi si ligjin substantiv edhe atë procedural. Pjesa përkatëse e vendimit të Gjykatës së Lartë arsyeton si në vijim:

"Referuar çështjes në fjalë, Dhoma Civile [e Gjykatës së Lartë] gjykon se apelimi i paraqitur nga paditësja Minerva Kotherja nuk i referohet ndonjërës prej situatave parashikuar në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, dhe si i tillë nuk duhet të pranohet. Gjykata e Apelit ka interpretuar dhe zbatuar me korrektësi si ligjin procedural edhe atë substantiv. Vendimi i saj nuk bie ndesh me ndonjë vendim të Dhomës Civile të Gjykatës së Lartë ose të Dhomave të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. [Gjykata e Lartë e mbledhur me dyer të mbyllura] nuk ka identifikuar ndonjë shkelje të tillë të rëndë të rregullave për procedurën, gjë që mund të bëjë të pavlefshëm vendimet [e gjykatave më të ulëta] ose procedurat [pranë këtyre gjykatave].

Gjykata e Apelit Durrës (...) i adresoi në mënyrën e duhur ankesat e bëra nga palët.

Dhoma [Civile] [e Gjykatës së Lartë] gjykon se të gjithë argumentet, në lidhje me pronësinë e tokës me sipërfaqe 156 metër katrorë, nuk kanë lidhje me këtë çështje. Zyra e Regjistrimit të Pasurive ka njohur pronësinë e pronarit të mëparshëm, paraardhësit të paditëses, dhe ky fakt nuk është kundërshtuar. Megjithatë, mosmarrëveshja në këtë çështje lidhet me pyetjen nëse trualli është [aktualisht] i zënë [nga palë të treta] ose jo, dhe nëse është i mundur rikthimi i tij, apo nëse ish-pronari ka të drejtën [vetëm] për kompensim. Gjykata e Apelit bëri të qartë se në lidhje me këto çështje ishte marrë një vendim nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive.

Në lidhje me shkaqet e ngritura në apelim, Dhoma [Civile] [e Gjykatës së Lartë] gjykon se ato kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe si të tilla nuk janë në juridiksionin kushtetues të Gjykatës së Lartë.".

VLERËSIMI I GJYKATËS

5. Mbështetur në nenin 6 § 1 të Konventës, kërkuesja u ankua se ishte shkelur parimi i sigurisë juridike, sepse fillimisht Gjykata e Lartë e shpalli apelimin e saj të pranueshëm, dhe më pas e shpalli po të njëjtin apelim të papranueshëm.

6. Gjykata vëren se ankesa ngre dy çështje të ndryshme. Çështja e parë ka të bëjë me vendimin e vitit 2016 të Gjykatës së Lartë për mbajtjen e një gjykimi me dyer të hapura, përpara se ta ndryshonte atë vendim në vitin 2021 dhe të vijonte me gjykimin e çështjes me një seancë me dyer të mbyllura. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata thekson se në përgjithësi është një parim i njohur që rregullat proceduralë të zbatohen menjëherë për procedurat që janë pezull (shih *Çela kundër Shqipërisë,* nr. 73274/17, § 27, 29 nëntor 2022, mbështetur në *Brualla Gómez de la Torre kundër Spanjës*, 19 dhjetor 1997, § 35, *Raporte të Gjykimeve dhe vendimeve* 1997-VIII, dhe *Galeano Peñas kundër Spanjës*, nr. 48784/20, § 52, 31 maj 2022). Për këtë arsye, fakti se Gjykata e Lartë zbatoi rregullat e reja për procedurën në seancat me dyer të hapura për çështjet e mbetura pezull në vetvete nuk ishte në kundërshtim me garancitë e dhëna në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës.

7. Çështja e dytë ka të bëjë me faktin se fillimisht Gjykata e Lartë e shpalli apelimin e kërkueses të pranueshëm dhe më pas të papranueshëm. Në lidhje me këtë çështje, Gjykata vëren se në vendimin e dytë të Gjykatës së Lartë, apelimi i kërkueses u shpall i papranueshëm pasi gjykata shqyrtoi meritat e pretendimeve të kërkueses për pikat e ligjit, sipas së cilit juridiksioni i saj ishte i kufizuar. Gjykata e Lartë vlerësoi se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar me korrektësi si ligjin procedural edhe atë substantiv, dhe kishin vlerësuar plotësisht argumentet që kërkuesja kishte paraqitur në apel. Gjithashtu, ajo konfirmoi gjetjet e Gjykatës së Apelit, në lidhje me mosmarrëveshjen kryesore në çështje dhe zgjidhjen e saj (shih paragrafin 4 më sipër). Në këto rrethana, fakti se apelimi u shpall i papranueshëm paraqet vetëm një gjetje formale, ndërsa në realitet Gjykata e Lartë vlerësoi me efikasitet meritat e ankesave të kërkueses të paraqitura përpara saj, dhe dha mjaftueshëm arsye për vendimin e saj.

8. Gjykata vlerëson se mbështetur në materialet në zotërim dhe për aq sa çështjet për të cilat janë bërë ankesat janë nën kompetencën e saj, këto ankesa nuk paraqesin ndonjë konstatim të shkeljes së të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në Protokollet e saj.

9. Në këto rrethana, kërkesa është qartazi e pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye Gjykata, në mënyrë unanime,

E shpall kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 2 tetor 2025.

KRYETAR
Úna Ní Raifeartaigh

ZËVENDËSSEKRETARE
Olga Chernishova

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA ISMAILAJ DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË
(Kërkesa nr. 28873/22)

VENDIM

Neni 6 § 1 (penal) – Mungesa e paanshmërisë së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë pasi ka shqyrtuar më herët meritat e procedurave të shkallës së parë të lidhura ngushtë, ndaj dy prej kërkuesve – Problematika të ngjashme themelore juridike të shqyrtuara në secilën prej procedurave, dhe që minimalisht janë të lidhura – Dyshime të justifikuara objektivisht në lidhje me opinionin e mundshëm të krijuar më herët nga gjyqtari – Asnjë masë e marrë për t'iu mundësuar kërkuesve të ngrinin çështjen e paanshmërisë në kohën e duhur. Neni 46 – Ekzekutimi i vendimit – Masat individuale – Rigjykimi ose rihapja e procedurave, nëse kërkohet, mënyra më e duhur për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të bërë korrigjimin.

Përgatitur nga Regjistri. Nuk detyron Gjykatën.

STRASBURG
8 korrik 2025

Ky vendim do të bëhet përfundimtar sipas rregullave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Ismailaj dhe të tjerë kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar,*
Lətif Hüseynov,
Darian Pavli,
Diana Kovatcheva,
Úna Ní Raifeartaigh,
Mateja Đurović,
Vasilika Sancin, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Në lidhje me:

kërkesën (nr. 28873/22) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") më 1 qershor 2022, nga shtetasit shqiptarë, z. Kastriot Ismailaj dhe znj. Lutfije Ismailaj dhe Adriatic Development Corporation Ltd SHPK ("kërkuesit");

vendimin për të njoftuar Qeverinë shqiptare ("Qeveria") për ankesën në lidhje me pretendimin për paanshmëri të gjykatës, dhe për të shpallur pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 17 qershor 2025,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimin për anshmëri të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë gjatë procedurave për konfiskimin e pasurive të kërkuesve sipas regjimit të konfiskimit edhe pa pasur një dënim të dhënë, parashikuar në të ashtuquajturin "Ligji antimafia" (ligji nr. 10192 i datës 3 dhjetor 2009, i ndryshuar, "Për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë").

FAKTET

2. Z. Kastriot Ismailaj (kërkuesi i parë) është i biri i znj. Lutfije Ismailaj (kërkuesja e dytë) dhe aksioner i vetëm dhe drejtor i Adriatic Development Corporation Ltd SHPK (kërkuesi i tretë), një kompani e themeluar sipas legjislacionit shqiptar. Kërkuesit u përfaqësuan nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë që e praktikojnë ligjin në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua nga Agjenti i saj në atë periudhë, z. O. Moçka, avokat i përgjithshëm i shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmblidhen si në vijim:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Në vitin 2008 dhe 2012, Prokuroria e Tiranës nisi dy hetime penale ndaj kërkuesit të parë mbështetur në dyshimin se ai kishte pastruar produkte nga aktivitete kriminale në kundërshtim me nenin 287 të Kodit Penal (Pastrim i produkteve nga krimi). Hetimet u ndërprenë në vitin 2010 dhe 2012 për mungesë provash dhe të elementeve që zbulonin një vepër penale, respektivisht. Në vitin 2014, ndaj kërkuesit të parë u ndërmor një hetim i ri për pastrim parash (nr. 6381/2014), me të cilin u bashkuan edhe dy hetimet e mëparshme. Kjo gjë u ndoq me inicimin e dy proceseve parandaluese korresponduese për konfiskimin e pasurive sipas ligjit antimafia, mbështetur në gjetjet e hetimit penal të vitit 2014.

II. GRUPI I PARË I PROCEDURAVE PËR KONFISKIMIN E PASURIVE

6. Më 27 prill 2016, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ("Gjykata e Shkallës së Parë") pranoi një kërkesë nga prokuroria e posaçme për konfiskimin e një sërë pasurish (llogari bankare) që i përkisnin kërkuesve të parë dhe të tretë për kryerjen e krimeve të rënda nga kërkuesi i parë, duke deklaruar se ishin përmbushur në mënyrë kumulative (shih paragrafin 19 në vijim) tri kushtet e parashikuara në nenin 24(1) të ligjit nr. 10192, i datës 3 dhjetor 2009 (i ndryshuar).

7. Trupa gjyqësore me tre gjyqtarë i asaj gjykate, duke përfshirë gjyqtarin K. K., konstatoi se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm, mbështetur në të dhëna, në lidhje me përfshirjen e kërkuesit të parë në aktivitete të pastrimit të parave trajtuar në nenin 287 të Kodit Penal, dhe se aktiviteti kriminal kishte nisur të kryhej që në vitin 2006, nga periudha e themelimit të kërkuesit të tretë dhe transferimit të shumave të para të parave tek ajo kompani. Ky konstatim

mbështetej kryesisht në përfundimet e hetimeve penale që ishin ndërmarrë në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2014 ndaj kërkuesit të parë. Veçanërisht, gjykata konstatoi se kërkuesi i tretë ishte një kompani e rreme që ishte krijuar me qëllimin e vetëm e kryerjes së veprës së pastrimit të parave. Transaksionet financiare të gjeneruara me anë të kësaj kompanie, që nuk kishin pasur asnjë logjikë ekonomike, u konstatuan se e kishin origjinën nga burime të dyshimta financiare që ishin përdorur për të mbuluar aktivitete kriminale të paligjshme. Kompania nuk kishte pasur asnjë aktivitet tregtar konkret dhe zero përfitime, sidoqoftë transaksionet financiare nga llogaritë e saj varionin në miliona euro me kompani që operonin nga një parajsë fiskale (Gjibraltari).

8. Gjithashtu, gjykata konstatoi se kërkuesi i parë dhe i tretë nuk kishin shkarkuar barrën e tyre të provës, pasi ata nuk kishin provuar se pasuritë e kontestuara ishin përfituar me anë të mjeteve të ligjshme. Së fundmi, konstatohej edhe se ishte përmbushur kushti i tretë i parashikuar nga ligji, sipas së cilit pasuritë duhet të ishin në zotërimin e plotë të personit që i nënshtrohej masës.

9. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për konfiskimin e pasurive të kërkuesve u la në fuqi në vijim nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe nga Gjykata e Lartë në vitin 2016, dhe për këtë arsye, ishte bërë përfundimtar dhe i ekzekutueshëm.

III. GRUPI I DYTË I PROCEDURAVE PËR KONFISKIMIN E PASURIVE

A. Procedurat e shkallës së parë dhe në apel

10. Më 16 qershor 2015, Prokuroria për Krimet e Rënda paraqiti një kërkesë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, ku në mbështetje të ligjit antimafia kërkonte konfiskimin e një sërë llogarive bankare të tjera dhe të një makine që i përkiste kërkuesve. Pas paraqitjes së një raporti të përgatitur nga eksperti për pasuritë dhe të ardhurat e kërkuesve, më 17 mars 2016, Gjykata e Shkallës së Parë pranoi kërkesën.

11. Për sa i përket hetimeve penale (nr. 6381/2014) që kishin nisur në periudhën midis vitit 2008 dhe 2014 ndaj kërkuesit të parë, gjykata konstatoi se ekzistonte dyshimi i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se ai kishte qenë i përfshirë në aktivitete kriminale të parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal që prej vitit 2006 – periudhë në të cilën u themelua kërkuesi i tretë dhe kur u transferuan shumat e parave tek ajo kompani. Veçanërisht, gjykata theksoi se kërkuesi i tretë ishte një kompani e rreme, e krijuar me qëllimin e vetëm për kryerjen e veprës së pastrimit të parave. Të gjitha transaksionet financiare të gjeneruara me anë të asaj kompanie, si edhe nga kompani të tjera të krijuara dhe të administruara nga kërkuesi i parë, nuk kishin logjikë ekonomike dhe ishin të lidhura me burime të dyshimta; nuk kishte asnjë aktivitet tregtar konkret, sidoqoftë transaksionet financiare në llogaritë e tyre varionin në miliona euro me kompani të krijuara në një parajsë fiskale (Gjibraltar).

12. Gjithashtu, gjykata konstatoi se kërkuesi i dytë dhe i tretë ishin persona të lidhur me kërkuesin e parë sipas interpretimit të ligjit dhe, për këtë arsye, mund të konsideroheshin subjekte të masës së konfiskimit. Së fundmi, gjykata konstaton se sipas ligjit, barra e provës binte mbi kërkuesit dhe ata nuk kishin provuar se fondet në llogaritë bankare, që në total ishin rreth një milion dollarë amerikanë, ishin fituar në mënyrë të ligjshme. Posedimi i këtyre pasurive konsiderohej se nuk korrespondonte me nivelin e të ardhurave, përfitimeve ose aktivitetet e ligjshme të deklaruara nga kërkuesit, dhe as nuk ishin justifikuar prej tyre në rrethanat kur përfitimi nga aktiviteti ose aktivitetet e tyre të ligjshme ishte zero.

13. Më 24 maj 2016, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë u la në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda. Përfundimet e saj mbështeteshin në provat e mbledhura gjatë hetimit penal nr. 6381/2014 (shih paragrafin 5 më sipër) ndaj kërkuesit të parë. Gjykata e apelit vendosi se këto prova ishin mjaftueshëm për të provuar dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi i parë kishte kryer një vepër penale, si dhe origjinën e paligjshme të pasurive të konfiskuara.

B. Procedurat e Gjykatës së Lartë

14. Më 22 qershor 2016, kërkuesit paraqitën një rekurs pranë Gjykatës së Lartë ndaj vendimeve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke listuar një sërë ankesash, që në thelb kishin të bënin me vlerësimin e fakteve dhe të provave të përdorura nga ato gjykata për të arritur në vendimet e tyre. Ndër të tjera, kërkuesit pretenduan se prokuroria nuk kishte ngritur një dyshim të arsyeshëm për përfshirjen e kërkuesve në aktivitete kriminale, për të identifikuar pasuritë e përftuara nga burime të dyshimta, dhe për të provuar lidhjen racionale midis këtyre dy elementeve.

15. Më 4 maj 2021, Gjykata e Lartë e mbledhur me dyer të mbyllura si një trupë penale prej tre

gjyqtarësh, ku përfshihej gjyqtari K. K., e rrëzoi rekursin në Gjykatën e Lartë të kërkuesve si të papranueshëm. Në dosjen e materialeve nuk ka asnjë tregues se palët ishin njoftuar për seancën e radhës dhe/ose për përbërjen e trupës gjyqësore. Me deklarimin e apelimit të papranueshëm, Gjykata e Lartë theksoi se ai nuk përmbushte asnjë prej kritereve për të pranuar një rekurs të tillë në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale. Veçanërisht, ajo theksonte se nuk i takonte Gjykatës së Lartë që të rishqyrtonte provat ose pikat e ligjit, dhe se juridiksioni i saj kufizohej vetëm në argumente juridikë. Gjithashtu, Gjykata e Lartë shtoi se ajo gjykonte se ishin përmbushur kushtet juridike në mbështetje të ligjit antimafia për konfiskimin e pasurive të kërkuesve.

16. Pjesët përkatëse të vendimit janë si në vijim:

"30. Kolegji Penal gjykon se asnjë prej pretendimeve të ngritura në rekursin në Gjykatën e Lartë nuk i referohet shkaqeve për një rekurs parashikuar në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale. Edhe pse Kolegji nuk shqyrton prova, ai gjykon se gjykatat më të ulëta i kanë vlerësuar me korrektësi kushtet për konfiskimin e provave [të kërkuesve], sipas parashikimeve në ligjin nr. 10192, të datës 3 dhjetor 2009... Kolegji vlerëson se të gjitha pretendimet e ngritura në rekurs janë ngritur edhe në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda dhe kanë marrë një përgjigje të arsyetuar prej saj...

32. Kolegji Penal vlerëson se ankesat që kanë lidhje me keqinterpretimin e provave dhe fakteve nuk duhet të merren në konsideratë prej saj, pasi vlerësimi i provave është një çështje që nuk përfshihet në juridiksionin juridik ekskluziv të Gjykatës së Lartë. Megjithatë, Kolegji vlerëson se vendimet e gjykatave më të ulëta janë arsyetuar në mënyrë shteruese dhe krijojnë bindjen e Kolegjit se konfiskimi i pasurive përmbush kushtet e parashikuara në ligjin nr. 10192."

C. Procedurat e Gjykatës Kushtetuese

17. Kërkuesit paraqitën një ankesë kushtetuese kundër vendimit të Gjykatës së Lartë. Ndër të tjera, ata pretenduan se apelimi i tyre në Gjykatën e Lartë nuk ishte gjykuar nga një trupë gjyqësore e paanshme për shkak të përfshirjes së mëparshme të gjyqtarit K. K. në procedurat e lidhura me çështjen ndaj kërkuesve (shih paragrafët 6–9 më sipër), që kishin të bënin me të njëjtat çështje faktike dhe ligjore që e shoqëronin çështjen në apel.

18. Më 2 dhjetor 2021, Gjykata Kushtetuese i rrëzoi ankesat kushtetuese të kërkuesve, duke përfshirë ankesën në lidhje me pretendimin për mungesë të paanshmërisë së Gjykatës së Lartë për shkak të pjesëmarrjes në procedura të gjyqtarit K. K., i cili në vitin 2016 kishte marrë pjesë si gjyqtar i shkallës së parë në një çështje kundër kërkuesit të parë dhe të tretë, dhe sipas ligjit antimafia kishte urdhëruar konfiskimin e disa llogarive bankare që i përkisnin atyre. Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë konstatoi se pasuritë (llogaritë bankare) e konfiskuara gjatë atyre dy procedimeve të veçanta ishin tërësisht të ndryshme, dhe arriti në përfundimin se nuk mund të kishte dyshime objektive për paanshmërinë e K. K.

KUADRI LIGJOR PËRKATËS

19. Ligji nr. 10192 i datës 3 dhjetor 2009 ("Ligji antimafia"), në fuqi në periudhën konkrete, parashikon kushtet për konfiskimin e pasurive të përftuara me anë të mjeteve të paligjshme. Pjesa përkatëse e ligjit parashikon:

Neni 3
Fusha e zbatimit

"....

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të:

a) personave të afërm... të subjekteve të pikës 1 të këtij neni [të dyshuarit kryesorë];

b) personave fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, a janë përdorur, kanë lehtësuar apo në një formë kanë ndikuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme nga personat e parashikuar në pikën 1 të këtij neni."

Neni 5
Marrëdhënia me procedimin penal

1. Procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji.

2. Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas këtij ligji, mbështeten në rregullat procedurale të këtij ligji dhe plotësohen nga rregulla të përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile."

Neni 24
Pranimi i kërkesës për konfiskim

1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme…; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.

20. Neni 5, paragrafi 2, i ligjit antimafia u ndryshua më pas me anë të ligjit nr. 70/2017, si në vijim:

"2. Verifikimi, hetimi dhe gjykimi sipas këtij ligji do të ndjekë rregullat proceduralë të këtij ligji, plotësuar nga rregullat e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, sipas rastit. Të dhënat e përftuara nga akte kriminale [mund] të përdoren në procedurën e parashikuar nga ky ligj."

21. Neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, në fuqi në periudhën kur kërkuesit paraqitën apelimin e tyre pranë Gjykatës së Lartë, parashikon si në vijim:

Neni 472
Vendime ndaj të cilave mund të ushtrohet rekurs

"Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë [dhe] vetëm [për shkaqet] si në vijim:

a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji;

b) ka shkelje të rënda të normave procedurale...

..."

22. Dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në fuqi në periudhën e gjykimit të rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë, përcakton si në vijim:

Neni 15
Papajtueshmëria për shkak të pjesëmarrjes në procedim

"1. Gjyqtari që ka dhënë ose që ka marrë pjesë në dhënien e vendimit në një shkallë të procedimit nuk mund të ushtrojë funksionet e gjyqtarit në shkallët e tjera, as të marrë pjesë në rigjykim apo rishikim pas prishjes së vendimit..."

Neni 17
Heqja dorë

1. Gjyqtari ka për detyrë të heqë dorë nga gjykimi i çështjes konkrete:

…

c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit; …

ë) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse i cili e miraton ose e refuzon atë me vendim të arsyetuar.

Neni 18
Përjashtimi i gjyqtarit

"1. Palët mund të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit:

a) në rastet e parashikuara nga nenet 15, … dhe 17 [të këtij Kodi];

b) kur gjatë ushtrimit të funksioneve dhe para se të jetë dhënë vendimi ai ka shfaqur mendimin e tij mbi faktet ose rrethanat objekt procedimi. 2. Gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit."

Neni 432
Rekursi kundër vendimeve të gjykatës së apelit

1. Rekursi në Gjykatën e Lartë kundër vendimeve të gjykatës së apelit mund të bëhet për këto shkaqe:

a) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material ose procedural, me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;

b) për mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave;

c) kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Kur e çmon të nevojshme, gjykata u kërkon palëve memorie me shkrim.

Neni 433
Mospranimi i rekursit

1. Rekursi nuk pranohet në qoftë se bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që lejon ligji, si dhe kur Gjykata e Lartë çmon se çështja nuk duhet të shqyrtohet prej saj, sipas përcaktimeve të paragrafit 1, të nenit 432, të këtij Kodi.

2. Mospranimi i rekursit vendoset nga një trup gjykues me tre gjyqtarë në dhomën e këshillimit.

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

23. Kërkuesit u ankuan se e drejta e tyre për një gjykim të paanshëm ishte shkelur për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit K. K. në procedurat pranë Gjykatës së Lartë ndaj tyre. Një gjë e tillë ishte në kundërshtim me garancitë e nenit 6 § 1 të Konventës, pjesa përkatëse e të cilit parashikon si në vijim:

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."

A. Pranueshmëria

24. Qeveria parashtroi se ankesa e kërkuesve ishte një ankesë "e shkallës së katërt" dhe se përbënte një shkelje të së drejtës për ankesë individuale në mbështetje të nenit 35 § 3 të Konventës. Në lidhje me kërkuesen e dytë, Qeveria parashtroi se ajo nuk kishte statusin e viktimës sipas nenit 34 të Konventës, pasi ajo nuk kishte qenë palë në procedimet në shkallën e parë ku mori pjesë gjyqtari K. K.

25. Kërkuesit parashtruan se kundërshtimeve të Qeverisë u mungonte merita dhe ishin të gabuara. Në lidhje me statusin e viktimës, kërkuesit pohuan se fakti se gjyqtari K. K. i cili tashmë kishte krijuar një mendim për meritat e çështjes mbështetur në gjykimin e tij në grupin e parë të procedimeve, ku kërkuesja e dytë nuk ishte e përfshirë, kishte ndikuar negativisht edhe ndaj kësaj të fundit, e cila ishte përfshirë vetëm në grupin e dytë të procedurave (shih *Urgesi dhe të tjerë kundër Italisë*, nr. 46530/09, §§ 94–95, 8 qershor 2023).

26. Gjykata vlerëson se pavarësisht se kërkuesja e dytë nuk ishte palë në grupin e parë të procedurave, ajo ende mund të vlerësohej se ishte ndikuar nga paanshmëria e gjyqtarit K. K. për shkak se ajo ishte një nga subjektet në grupin e dytë të procedurave, së bashku me dy kërkues të tjerë. Veçanërisht, të dy procedimet kishin të bënin me konfiskimin e pasurive të ndryshme për shkak të aktivitetit kriminal të kërkuesit të parë. Kërkuesja e dytë, nëna e tij, u prek si person i afërt (shih nenin 3 të ligjit antimafia, paragrafi 19 më sipër), me anë të konfiskimit të pasurive (llogari bankare) në emrin e saj, me pretendimin se ishin produkte nga të ardhurat prej aktiviteteve kriminale të të birit të saj, për të cilat u iniciuan të dy grupet e procedimeve.

27. Për sa i përket pretendimit të Qeverisë se kërkuesit kishin abuzuar me të drejtën e tyre për të bërë një ankesë, parimet përkatëse parashikohen, për shembull, në *Gross kundër Zvicrës* ([DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). Veçanërisht, Gjykata thekson se një kërkesë mund të rrëzohet si abuzim me të drejtën për të bërë një kërkesë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, të tilla si për shembull, nëse ajo do të ishte mbështetur me dijeni në fakte të pavërteta (shih, për shembull, *Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §§ 53–54, *Raporte të gjykimeve dhe vendimeve* 1996-IV; *Varbanov kundër Bullgarisë*, nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X; dhe *Popov kundër Moldavisë (nr. 1),* nr. 74153/01, § 49, 18 janar 2005). Qëllimi i kërkuesit për të mashtruar Gjykatën duhet të mbështetet me siguri të mjaftueshme (shih *Gross*, cituar më sipër, § 28). Megjithatë, në çështjen konkrete nuk ekziston një indicie e tillë, për këtë arsye ky kundërshtim i bërë nga Qeveria duhet të rrëzohet.

28. Gjykata thekson se kërkesa nuk është as e pambështetur në fakte dhe as e papranueshme për shkaqe të tjera të listuara në nenin 35 të Konventës.

Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Meritat

1. Parashtrimet e palëve

29. Kërkuesit u ankuan se Gjykata e Lartë, që kishte gjykuar ankesën për masën e konfiskimit ndaj tyre, nuk kishte qenë e paanshme, për shkak të pranisë në kolegj të gjyqtarit K. K., i cili më herët kishte shprehur opinionin e tij për meritat e çështjes së tyre, dhe veçanërisht, për shkaqet kryesore mbi të cilat mbështetej konfiskimi i pasurive të tyre, më konkretisht: dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi i parë ishte përfshirë në aktivitete kriminale dhe origjina e paligjshme e pasurive të tyre (grupi i parë i procedimeve).

30. Kërkuesit u mbështetën në ngjashmëritë midis dy grupeve të procedimeve, veçanërisht, se përfundimet e lidhura me çështjen mbështeteshin në të njëjtat supozime juridike dhe faktike, dhe në faktin se ato kishin rezultuar nga i njëjti hetim për përfshirjen e kërkuesit të parë në aktivitete kriminale, përfundime të arritura në të dyja çështjet nga ekzaktësisht të njëjtat prova. Në lidhje me këtë, ata u mbështetën tek *Indra kundër Sllovakisë* (nr. 46845/99, § 53, 1 shkurt 2005), dhe *Urgesi dhe të tjerë* (cituar më sipër, §§ 92 dhe 95). Sipas kërkuesve, fakti se në vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ishte përdorur i njëjti formulim, në secilin prej të dy grupeve të procedimeve kishte prova për ngjashmërinë e tyre.

31. Veçanërisht, mbështetur në provat e mbledhura në kontekstin e procedurave penale të ndërmarra ndaj kërkuesit të parë, gjykatat vendase kishin konstatuar në të dy grupet e procedimeve se kërkuesi i tretë kishte qenë një kompani e rreme, që ishte krijuar me qëllimin e vetëm për të kryer veprën e pastrimit të parave, dhe se flukset financiare të gjeneruara nga një kompani e tillë, dhe pasuritë e mbledhura nga kërkuesi i parë (dhe nën zotërimin e këtij të fundit në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë) pas fillimit të aktivitetit kriminal (pas vitit 2006), duhej të konsideroheshin që të gjitha si pasuri me origjinë të paligjshme.

32. Gjithashtu, mbështetur në *Toziczka kundër Polonisë* (nr. 29995/08, §§ 43–46, 24 korrik 2012) dhe *Indra* (cituar më sipër, § 53), kërkuesit parashtruan se gjyqtari K. K., kur ishte pjesë e trupës gjykuese në Gjykatën e Lartë që kishte gjykuar çështjen e tyre, ishte thirrur për të vendosur nëse duhej të lihej në fuqi ose jo interpretimi i tij juridik i së drejtës materiale në një gjykim të mëparshëm dhënë në të njëjtën çështje. Ata parashtruan se fakti se i njëjti gjyqtar ishte thirrur për të vendosur nëse vet ai kishte bërë një gabim ose jo në interpretimin juridik apo në kërkesë ishte mjaftueshëm për të provuar se dyshimet për mungesën e paashmërisë nga ana e tij ishin të justifikuara objektivisht. Kërkuesit parashtruan se kolegji i Gjykatës së Lartë që kishte gjykuar çështjen e tyre gjatë procedurave të kontestuara nuk ishte kufizuar në rrëzimin e ankesës së tyre si të papranueshme, por kishte vlerësuar meritat e arsyeve të tyre për apelim (kërkuesit iu referuan paragrafit 32 të vendimit të Gjykatës së Lartë – shih paragrafin 16 më sipër).

33. Qeveria përsëriti argumentet e Gjykatës Kushtetuese në çështjen konkrete, duke pohuar se dy grupet e procedimeve kishin qenë tërësisht të ndryshme pasi kishin të bënin me konfiskimin e pasurive të ndryshme. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se në procedimet e kontestuara, Gjykata e Lartë, me pjesëmarrjen e gjyqtarit K. K., kishte vendosur për pranueshmërinë e rekursit, një aspekt procedural dhe jo për meritat e çështjet. Qeveria u mbështet në *Morel kundër Francës* (nr. 34130/96, GJEDNJ 2000-VI).

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Parimet e përgjithshme

34. Gjykata përsërit se paanshmëria normalisht është tregues i mungesës së paragjykimit, dhe ekzistenca e saj mund të shqyrtohet në mënyra të ndryshme. Sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllime të nenit 6 § 1 duhet të përcaktohet sipas një shqyrtimi të aspektit subjektiv ku duhet të mbahet në konsideratë bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar, që do të thotë, nëse gjyqtari rezervonte ndonjë paragjykim apo anësi personale në një çështje të caktuar; dhe gjithashtu edhe sipas testimit të aspektit objektiv, që do të thotë duke parashtruar nëse vetë gjykata, dhe midis aspekteve të tjera, përbërja e saj, kishte ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanshmërinë e saj (shih, për shembull, *Kyprianou kundër Qipros* [DHM], nr. 73797/01, § 118, GJEDNJ 2005-XIII; *Micallef kundër Maltës* [DHM], nr. 17056/06, § 93, GJEDNJ 2009; *Morice kundër Francës* [DHM], nr. 29369/10, § 73, GJEDNJ 2015; dhe *Ilnseher kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 10211/12 dhe 27505/14, § 287, 4 dhjetor 2018).

35. Për sa i përket shqyrtimit të anës subjektive, parimi se një gjykatë duhet të prezumohet të jetë e lirë nga paragjykimi personal ose anshmëria është prej shumë kohësh pjesë e praktikës gjyqësore të Gjykatës (shih *Kyprianou,* § 119; *Micallef,* § 94; dhe *Morice*, 74, të gjithë cituar më sipër). Paanshmëria personale e një gjyqtari duhet të prezumohet derisa të ketë provë për të kundërtën (shih *Hauschildt kundër Danimarkës*, 24 maj 1989, § 47, seritë A nr. 154). Në lidhje me llojin e provës së kërkuar, Gjykata ka kërkuar që të konstatohet, për shembull, nëse një gjyqtar ka shfaqur armiqësi ose keqdashje për arsye personale (shih *De Cubber kundër Belgjikës*, 26 tetor 1984, § 25, seritë A nr. 86, dhe *Morice*, cituar më sipër, § 74).

36. Për sa i përket testimit të aspektit objektiv, duhet të përcaktohet nëse, përtej sjelljes së gjyqtarit, ka fakte të konstatuara që mund të ngrenë dyshime për paanshmërinë e tij apo të saj. Kjo nënkupton se, kur vendoset nëse në një çështje të caktuar ka arsye legjitime për të pasur frikë se një gjyqtari, apo organi të caktuar të mbledhur si një trupë gjykuese, i mungon paanshëmira, këndvështrimi i personit në fjalë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Ajo çfarë është vendimtare është nëse kjo frikë mund të provohet se justifikohet nga aspekti objektiv (shih *Micallef,* cituar më sipër, § 96).

37. Në lidhje me këtë, edhe dukja mund të jetë e një rëndësie të caktuar, ose me fjalë të tjera, "nuk duhet që drejtësia vetëm të bëhet, por gjithashtu duhet të jetë e dukshme se po bëhet" (shih *De Cubber,* cituar më sipër, § 26). Ajo që është në rrezik është besimi që duhet të frymëzojnë në publik gjykatat në një shoqëri demokratike. Për këtë arsye, çdo gjyqtar për të cilin ekziston një arsye legjitime për të pasur frikë për mungesën e paanshmërisë duhet të tërhiqet (shih *Castillo Algar kundër Spanjës*, 28 tetor 1998, § 45, *Raporte* 1998-VIII; *Micallef*, cituar më sipër, § 98; dhe *Morice,* cituar më sipër, § 78).

38. Gjykata përsërit se fakti i thjeshtë se një gjyqtar ka marrë vendime të mëparshme në lidhje me të njëjtën vepër penale në vetvete nuk mund të justifikojë frikën për paanshmërinë e tij apo të saj. Gjithashtu, fakti i thjeshtë se një gjyqtar tashmë ka gjykuar akuza penale të ngjashme apo të palidhura me njëra-tjetrën, apo se ai ose ajo tashmë ka gjykuar një të bashkëpandehur në procedura penale të ndryshme, në vetvete nuk është mjaftueshëm për të dyshuar paanshmërinë e këtij gjyqtari në një çështje në vijim (shih *Meng kundër Gjermanisë*, nr. 1128/17, § 47, 16 shkurt 2021, me referenca të tjera).

b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

39. Në çështjen konkrete, kërkuesit nuk paraqitën ndonjë provë se gjyqtari K. K. kishte shfaqur anshmëri personale ndaj tyre. Për këtë arsye, çështja duhet të shqyrtohet nga perspektiva e testimit të paanshmërisë objektive (krahaso *Teslya kundër Ukrainës*, nr. 52095/11, § 42, 8 tetor 2020).

40. Në lidhje me thelbin e ankesës, Gjykata vëren se aspekti i mungesës së paanshmërisë gjyqësore në çështjen konkrete është funksional në natyrë: që do të thotë, në rastin kur sjellja personale e gjyqtarit nuk vihet në dyshim, por në rastin kur, për shembull, ushtrimi i funksioneve të ndryshme në procesin gjyqësor nga i njëjti person mund të justifikojë objektivisht dyshime për paanshmërinë e gjyqësorit, duke mos përmbushur në këtë mënyrë standardin e Konventës sipas testit objektiv (shih *Kyprianou*, cituar më sipër, § 121, dhe *Morice*, cituar më sipër, §§ 73–78).

41. Gjykata thekson se shqetësimet e kërkuesve në lidhje me paanshmërinë e Gjykatës së Lartë ishin pasojë e faktit se i njëjti gjyqtar K. K., i cili më herët kishte shqyrtuar meritat e procedurave të lidhura ngushtë ndaj dy prej kërkuesve, ishte pjesë e trupës gjykuese të asaj gjykate. Mund të pranohet se kjo situatë mund të ngrejë dyshime në mendjet e kërkuesve për paanshmërinë e asaj gjykate. Megjithatë, Gjykata ka vendosur nëse këto dyshime justifikoheshin objektivisht (krahaso *Morel*, cituar më sipër, § 44, dhe *Toziczka*, cituar më sipër, § 38). Përgjigja për këtë pyetje varet nga vlerësimi i rrethanave individuale për secilën çështje (shih *Borg kundër Maltës,* nr. 37537/13, § 89, 12 janar 2016). Për këtë arsye, Gjykata duhet të vlerësojë nëse problematikat e shqyrtuara nga Gjykata e Shkallës së Parë ndaj kërkuesit në procedura të veçanta ishin analoge me ato të shqyrtuara nga Gjykata e Lartë në grupin e kontestuar të procedimeve, dhe nëse po, nëse gjykata e nivelit të lartë u shpreh për meritat e të njëjtave problematikave juridike (shih *Morel*, cituar më sipër, §§ 47–48).

42. Gjykata vëren se më 27 prill 2016, Gjykata e Shkallës së Parë, në procedura të veçanta për rikuperimin e pasurive ndaj dy kërkuesve, konfiskoi disa prej llogarive të tyre bankare mbështetur në ligjin nr. 10192. Në ato procedura, me pjesëmarrjen e gjyqtarit K. K., gjykata konstatoi se kërkuesit nuk

kishin justifikuar origjinën e ligjshme të fondeve në ato llogari bankare. Në vijim, ai vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda dhe Gjykata e Lartë në vitin 2016.

43. Gjykata vlerëson se problematikat juridike të mbajtura në konsideratë nga Gjykata e Lartë në procedimet e kontestuara ishin të ngjashme, dhe të paktën, të lidhura, me problematikat e trajtuara nga gjykatat më të ulëta në grupin e parë të procedimeve. Argumenti i Qeverisë se çështjet ishin tërësisht të ndryshme sepse kishin të bënin me pasuri të ndryshme nuk është bindës. Gjykata vlerëson se të dy grupet e procedimeve mbështeteshin në prova që vinin nga i njëjti hetim penal, që lidhej kryesisht me të njëjtat akuza që përfshinin pastrim parash nga individët dhe kompanitë në fjalë, dhe që kërkonin shkaqe juridike të ngjashme për konfiskimin e pasurive të kërkuesve.

44. Gjykata vëren se kërkuesit u mbështetën në një linjë të praktikës gjyqësore ku Gjykata ka konstatuar një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, sepse një gjyqtar, i cili më herët ishte përfshirë në një çështje kundër kërkuesit(ve), në vijim kishte gjykuar një apelim për pikat e ligjit në Gjykatën e Lartë (shih *Indra*, cituar më sipër, §§ 51–55, dhe *Toziczka*, cituar më sipër §§ 37–46). Veçanërisht, në këto çështje Gjykata vlerësonte se procedurat e kontestuara ishin mbështetur në të njëjtin grup faktesh dhe përfshinin gjyqtarin në fjalë për gjykimin e problematikave të lidhura me një gjykim të mëparshëm. Gjithashtu, në *Urgesi dhe të tjerë* (cituar më sipër, §§ 90–97), Gjykata vlerësonte se problematikat që iu paraqitën gjyqtarit në fjalë për shqyrtim në secilin prej dy grupeve të procedimeve (fillimisht në cilësinë e prokurorit dhe më pas si gjyqtar), në lidhje me të gjithë paditësit, në thelb ishin të njëjta, ose minimalisht të lidhura ngushtë.

45. Gjykata konstaton merita në argumentet e kërkuesve. Në rrethanat e çështjes konkrete, nuk ishte e paarsyeshme që kërkuesit të mendonin se gjyqtari K. K., i cili ishte gjyqtar në Gjykatën e Lartë, mund të ketë pasur një këndvështrim të paramenduar për meritat e çështjes (që do të thotë, për ligjshmërinë e përgjithshme të konfiskimeve) për gjykimin e tij në shkallën e parë në procedura shumë të ngjashme ndaj dy prej palëve. Për këtë arsye, për paanshmërinë e tij mund të lindin dyshime të justifikuara objektivisht. Gjykata mban në konsideratë faktin se në sistemin shqiptar të shqyrtimit të rekursit, Gjykata e Lartë vepron si gjykatë me një fushëveprim të kufizuar për shqyrtim për sa i përket zbatimit të juridiksionit substantiv apo procedural nga gjykatat më të ulëta. Megjithatë, Gjykata vëren se në çështjen konkrete kolegji i Gjykatës së Lartë, në fakt, u shpreh në një masë të caktuar për meritat e çështjes, kur vendosi për pranueshmërinë e rekursit (shih paragrafin 16 më sipër). Sipas rrethanave, Gjykata është e mendimit se gjyqtari K. K. e gjeti veten në një situatë atij iu kërkua efektivisht që të vendoste për interpretimin e tij të mëparshëm juridik ose zbatimin e ligjit substantiv në procedura të lidhura ngushtë me çështjen ndaj kërkuesve (shih *Toziczka*, cituar më sipër, § 43).

46. Në vijim, Gjykata vëren se në dosjen e çështjes nuk ka asnjë tregues, por as Qeveria nuk ka pretenduar, se kërkuesit ishin njoftuar paraprakisht për seancën e datës 4 maj 2021 dhe/ose përbërjen e Kolegjit të Gjykatës së Lartë (shih nenin 433 të KPC-së, paragrafi 22 më sipër; shih edhe *Federata e Golfit Kroaci kundër Kroacisë*, nr. 66994/14, §§ 112–13, 17 dhjetor 2020). Gjithashtu, nuk ka informacion nëse kolegji i Gjykatës së Lartë e konsideronte konfliktin e mundshëm të interesit *proprio motu*. Në rrethana të tilla, çdo gjyqtar për të cilin mund të ekzistojë një arsye legjitime për të pasur dyshime për mungesën e paanshmërisë duhet të mbajë në konsideratë nevojën për t'u tërhequr nga procedurat (shih *Castillo Algar*, cituar më sipër, § 45; *Morice*, cituar më sipër, § 78; dhe *Škrlj kundër Kroacisë*, nr. 32953/13, § 43, 11 korrik 2019). Një mundësi e tillë rezulton të jetë e parashikuar nga rregullat e procedurës penale në sistemin e brendshëm (shih nenin 17 të KPC-së, paragrafi 22 më sipër). Specifikisht, është përgjegjësi e secilit gjyqtar të identifikojë çdo pengesë në pjesëmarrjen e tij ose të saj, dhe ose të tërhiqet; ose kur përballet me një situatë në të cilën është e diskutueshme nëse ai apo ajo duhet të skualifikohet, edhe pse nuk përjashtohet në mënyrë të qartë nga ligji, ta sjellë çështjen në vëmendjen e palëve për t'i dhënë atyre mundësinë që të kundërshtojnë pjesëmarrjen e gjyqtarit (shih *Sigríður Elín Sigfúsdóttir kundër Islandës,* nr. 41382/17, § 35, 25 shkurt 2020). Megjithatë, në çështjen konkrete rezulton se nuk është marrë asnjë masë e tillë që do t'i kishte bërë të mundur kërkuesve ta ngrinin çështjen e paanshmërisë në kohën e duhur.

47. Mbështetur në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës në lidhje me kërkesën për një gjykatë të paanshme.

II. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

48. Neni 46 i Konventës parashikon:

"1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë."

49. Kërkuesit kërkuan rishqyrtimin ose rihapjen e procedurave të brendshme si masa individuale të përshtatshme për *restitutio in integrum* për të korrigjuar të metat procedurale dhe për të risjellë situatën që do të kishte ekzistuar nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja.

50. Gjykata ka ritheksuar se, teksa kryesisht i takon Shtetit në fjalë që të zgjedhë mjetet që do të përdorë në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij sipas nenit 46 të Konventës, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse është e nevojshme, në parim paraqet mënyrën e duhur për të korrigjuar një shkelje të nenit 6, veçanërisht në rastet kur Gjykata ka konstatuar se gjykata vendase nuk ka përmbushur kërkesat e Konventës për pavarësi dhe paanshmëri (shih *Öcalan kundër Turqisë* [DHM], nr. 46221/99, § 210, GJEDNJ 2005-IV, dhe *Urgesi dhe të tjerë*, cituar më sipër, § 104). Gjykata konstaton se në parim kjo është e mundur në sistemin juridik shqiptar (*Hysi kundër Shqipërisë*, nr. 72361/11, § 43, 22 maj 2018; *Meli kundër Shqipërisë*, nr. 41373/21 dhe 48801/21, § 83, 16 korrik 2024; *Gaba kundër Shqipërisë*, nr. 33369/17, § 101, 17 dhjetor 2024).

B. Neni 41 i Konventës

51. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

1. Dëmshpërblimi

52. Kërkuesit kërkuan 45,000 euro (15,000 euro secili) për dëmin jopasuror për stresin, pasigurinë dhe humbjen e mundësisë procedurale si pasojë e rezultatit të procedurave të brendshme konkrete.

53. Qeveria parashtroi se pretendimet për dëmin jopasuror ishin të pambështetura në fakte dhe të ekzagjeruara.

54. Gjykata i akordon kërkuesve shumën në total prej 3,500 eurosh për dëmin jopasuror, plus çdo taksë të tarifueshme.

2. Kostot dhe shpenzimet

55. Kërkuesit kërkuan edhe 6,500 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat e brendshme dhe 41,880 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra pranë Gjykatës.

56. Qeveria parashtroi se kërkuesit nuk kishin paraqitur prova mbështetëse për shpenzimet e bëra pranë gjykatave vendase (duke përfshirë faturat, gjë që ishte kërkesë sipas juridiksionit shqiptar), dhe se në çdo rast, pretendimet e kërkuesve ishin të paarsyeshme.

57. Në lidhje me shpenzimet e bëra pranë Gjykatës, Qeveria argumentoi se informacioni i paraqitur nga kërkuesit ishte shumë i përgjithshëm, pasi kërkuesit nuk kishin specifikuar informacione të tilla si shuma e orëve të punës të shpenzuara dhe nga sa avokatë; dhe se këto informacione nuk ishin të mjaftueshme për të përcaktuar nëse ishte e nevojshme që të bëheshin këto shpenzime për qëllimin e përfaqësimit të tyre pranë Gjykatës. Gjithashtu, disa shpenzime nuk ishin bërë ende (rreth gjysma) dhe pagesat për shpenzimet që faktikisht ishin bërë, ishin kryer nga një person i paidentifikuar pa objekt të specifikuar për transfertat. Së fundmi, Qeveria parashtroi se ato shpenzime ishin shumë më të larta sesa norma normale në Shqipëri, dhe gjithashtu tejkalonin limitin ligjor për shpenzime të tilla (në përputhje me aktin nënligjor të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shqipëri). Qeveria u mbështet në *Bici kundër Shqipërisë* (nr. 5250/07, § 59, 3 dhjetor 2015).

58. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm në masën sa është provuar se ato faktikisht, dhe sipas nevojës, janë kryer dhe janë të arsyeshme për kuant. Në çështjen konkrete, duke iu referuar dokumenteve në zotërimin e saj dhe kritereve të mësipërme, Gjykata rrëzon kërkesën për kostot dhe shpenzimet në procedimet e brendshme dhe e konsideron të arsyeshme që të akordojë shumën prej 5,000 euro për procedurat pranë Gjykatës, plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT,

1. E shpall kërkesën të pranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 i Konventës;

3. Gjykon:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesve bashkërisht, brenda tre muajve nga data në të cilën

vendimi bëhet përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e dëmshpërblimit:

i. 3,500 euro (tre mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;

ii. 5,000 euro (pesë mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës tremujore të përmendur më sipër deri në dëmshpërblim duhet të paguhet interes i thjeshtë për shumat e mësipërme në normën e barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindje;

4. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesve për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 8 korrik 2025, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Peeter Roosma
KRYETAR

Olga Chernishova
ZËVENDËSREGJISTRARE

SHTOJCË
LISTA E KËRKUESVE

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia/themelimi	Vendbanimi
1	Kastriot ISMAILAJ	1963	Shqiptar	Tiranë
2	Lutfije ISMAILAJ	1941	Shqiptare	Tiranë
3	ADRIATIC DEVELOPMENT CORPORATION Ltd	2006	Shqiptare	Tiranë

VENDIM
Nr. 49, datë 24.9.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj kryetare;
Marsida Xhaferllari anëtare;
Fiona Papajorgji anëtare;
Sandër Beci anëtar;
Ilir Toska anëtar;
Genti Ibrahimi anëtar;
Marjana Semini anëtare;
Sonila Bejtja anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 23.9.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (Gj) 2024 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, përfaqësuar nga gjyqtarja Valjona Haxhiraj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Herald Jonuzaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 134, pika 1, shkronja "dh" dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 112 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (*gjykata referuese*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.7.2024, ora 12:30, në qytetin e Korçës, shtetasi T. B., gjatë drejtimit të motomjetit, është përplasur me një automjet të drejtuar nga shtetasja O. M. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se mjeti i drejtuar nga shtetasi T. B. bënte pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që drejtuesi i tij (shtetasi T. B.) ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, e cila, sipas shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor, *"është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç*". Për shkak se nga verifikimi i drejtuesit të mjetit shtetasi T. B. ka rezultuar se ishte i moshës 20 vjeç, për rrjedhojë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë (*Prokuroria Korçës*) ka regjistruar ndaj tij procedimin penal nr. 900/2024, për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal (*KP*), i cili parashikon se "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet*". Në vijim, në datën 21.10.2024, Prokuroria Korçës ka paraqitur në gjykatën referuese kërkesë për dërgimin e kësaj çështjeje në gjyq.

2. Në seancën paraprake të datës 5.12.2024, të zhvilluar në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, shtetasi T. B. ka parashtruar përpara gjykatës referuese se edhe pse është i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, ai di të drejtojë motomjetin e tij të kategorisë A1, me të cilin ka rreth dy vjet që punon (transporton pica). Po sipas shtetasit T. B., ai ka kërkuar të regjistrohej në kursin e lejedrejtimit të kategorisë A1, por kanë qenë drejtuesit e autoshkollave që i kanë thënë se nuk ishte e nevojshme, për shkak se ishte i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B. Po gjatë seancës paraprake, mbrojtësi i shtetasit T. B. i ka kërkuar gjykatës referuese të pezullojë gjykimin dhe t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e kësaj dispozite, nisur nga fakti që neni 291 i KP-së, i cili parashikon veprën penale për të cilën akuzohet i përfaqësuari prej tij, referon te shkronja "ë", e pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor. Gjykata referuese, pasi është tërhequr në dhomën e këshillimit, me vendimin e datës 5.12.2024, ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes në shqyrtim përpara saj dhe t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor.

3. Në datën 20.12.2024, në Gjykatë është regjistruar vendimi i gjykatës referuese, sipas objektit të mësipërm, dhe Kolegji i Gjykatës në datën 13.2.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

4. ***Gjykata referuese***, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar:

i. *Për legjitimimin*

4.1 Ajo legjitimohet në kërkesën e saj drejtuar Gjykatës, pasi bën pjesë në kategorinë e subjekteve që mund ta vënë në lëvizje atë, bazuar në nenet 134, 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 3, shkronja "dh", të ligjit nr. 8577/2000. Sipas gjykatës referuese, neni 291 i KP-së, që zbatohet në rastin e paraqitur për shqyrtim përpara saj, referon drejtpërdrejt në dispozitën e kundërshtuar dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me të, e cila po ashtu është e vetmja dispozitë që zbatohet në atë gjykim. Po kështu, gjykata referuese ka argumentuar se nuk ka asnjë mundësi që të bëhet interpretimi pajtues i dispozitës së kundërshtuar dhe se për çështjen e paraqitur për gjykim përpara saj nuk ka dispozita të tjera ligjore, mbi bazën e të cilave të zgjidhet ajo. Për këto arsye, sipas gjykatës referuese, çështja e paraqitur për shqyrtim përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja konkrete e paraqitur për shqyrtim në Gjykatë.

ii. *Për themelin*

4.2 Dispozita e kundërshtuar cenon *lirinë e lëvizjes dhe të drejtën për punë,* të parashikuara nga nenet 38 dhe 49 të Kushtetutës dhe ky kufizim nuk respekton *parimin e proporcionalitetit,* sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak se kushti i vendosur në shkronjën "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor nuk i përgjigjet zhvillimit social, kulturor, ekonomik dhe moral të shoqërisë, duke mos respektuar thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Nga relacionet që kanë shoqëruar ndryshimet në

Kodin Rrugor nuk jepet asnjë shpjegim se përse është vendosur ky kufizim për shkak të moshës. Ligjvënësi ka ndërmarrë një masë kufizuese për të mbrojtur të drejtat e njeriut, sigurinë e qarkullimit rrugor, jetën, shëndetin dhe pronën nga rreziku eventual dhe potencial që mund të ketë drejtimi i mjeteve rrugore nga persona që nuk janë të aftë t'i drejtojnë ato. Megjithatë, rreziku eventual dhe potencial është i njëjtë si për personat e aftë që njohin rregullat e qarkullimit rrugor e që drejtojnë mjetet me lejen përkatëse, ashtu edhe për ata që nuk kanë lejen përkatëse të drejtimit, por një leje tjetër, të cilët po ashtu janë njësoj të aftë fizikisht e mendërisht t'i drejtojnë ato mjete njësoj si personat që kanë lejen përkatëse.

4.3 *Është cenuar parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit,* sipas nenit 18 të Kushtetutës, për shkak të vendosjes së kufizimit për efekt të moshës, çka përbën një diskriminim të paarsyeshëm. Dispozita e kundërshtuar e Kodit Rrugor trajton në mënyrë të pabarabartë drejtuesit e motomjeteve me drejtuesit e mjeteve të tjera dhe nuk është në përputhje me legjislacionin evropian. Për trajtimin jo të barabartë përpara ligjit që u bëhet drejtuesve të motomjeteve nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, e përfundojnë atë me sukses, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Nuk ka asnjë studim ose statistikë për vendosjen e kufizimit të moshës 21 vjeç për drejtimin e motomjeteve dhe nuk ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive për vendosjen e tij. Në këtë mënyrë, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji.

4.4 Dispozita objekt kërkese bie në kundërshtim edhe me *parimin e shtetit të së drejtës edhe me të drejtën për t'u mos u dënuar pa ligj,* sipas neneve 4 dhe 29 të Kushtetutës dhe nenit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), pasi ligjvënësi nuk ka bërë një zgjedhje dhe zgjidhje proporcionale me nevojën dhe gjendjen që e ka diktuar atë, si dhe nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë në ligjin penal dhe në përgjegjësinë penale që mbajnë personat që kanë rrezikshmëri të njëjtë shoqërore në veprimet që kryejnë. Në rastin konkret mungon arsyeja e kriminalizimit të një sjellje njerëzore, konkretisht rrezikshmëria shoqërore penale, pasi fakti që drejtuesi nuk është të paktën 21 vjeç, nuk përmbush asnjë nga tre kriteret për të pasur vepër penale (rrezikshmëria shoqërore e veprës, kundërligjshmëria e saj dhe faji). Drejtimi i mjetit nga individi pa lejen përkatëse, në kushtet kur ai ka aftësi ta drejtojë atë, pasi ka leje drejtimi të një kategorie tjetër, e cila përfshin lejen që i duhej atij për të drejtuar atë mjet, përbën vetëm shkelje administrative dhe nuk mund të përbëjë edhe përgjegjësi penale. Për pasojë, i gjithë procesi gjyqësor do të jetë i paragjykuar dhe jokushtetues.

4.5 Dispozita objekt kërkese cenon *parimin e prezumimit të pafajësisë,* të parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, dhe bie në kundërshtim me nenet 33 dhe 42 të saj (Kushtetutës) dhe nenin 6 të KEDNJ-së, pasi në rastin konkret ligji e parashikon si krim kushtin e mospasjes së moshës të paktën 21 vjeç për të drejtuar motomjete të kategorisë A1. Po kështu, në rastin konkret, të pandehurit nuk i jepet mundësia të provojë mungesën e çdo rrezikshmërie të mundshme penale në veprimet e tij dhe për pasojë edhe faktin që nuk ka vepër penale. Në këtë rast, ligji jo vetëm që shkel të drejtën e të pandehurit për t'u prezumuar i pafajshëm, por këmbëngul në fajësinë e tij dhe në përgjegjësinë penale të padiskutueshme vetëm nga fakti se provohet se ai nuk është të paktën 21 vjeç.

4.6 Dispozita objekt kërkese cenon edhe *parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve,* të parashikuar në nenet 7 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës*,* pasi duke vendosur një kriter thjesht formal, siç është mosha mbi 21 vjeç për penalizimin e një sjellje njerëzore si krim, ligjvënësi u ka hequr mundësinë gjykatave që në ushtrimin e funksionit të tyre për dhënien e drejtësisë të vlerësojnë nëse ka ose jo vepër penale, referuar rrethanave konkrete të ngjarjes të sjellë si fakt penal nga organi i akuzës. Për rrjedhojë, gjykatat janë të detyruara të shpallin fajtor të pandehurin vetëm me vërtetimin e mosplotësimit të kushtit të moshës 21 vjeç, pa provuar (mos) aftësinë e tij në drejtimin e motomjetit. Kështu mund të konsiderohet krim drejtimi i mjetit pa pasur lejen e drejtimit, por jo përmbushja e kriterit të moshës dhe pasja e një lejeje drejtimi të një kategorie tjetër dhe kur është e provuar që personi ka aftësitë për të drejtuar mjetin për të cilin nuk disponon lejen përkatëse të drejtimit.

5. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi***, nuk ka paraqitur prapësime, edhe pse është njoftuar rregullisht.

6. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave***, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

i. *Për legjitimimin e gjykatës referuese*

6.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet për shkak se nuk ka parashtruar arsye të mjaftueshme, bindëse dhe serioze për antikushtetutshmërinë e normës ligjore të kundërshtuar, por e ka paragjykuar atë, duke mos i dhënë kuptimin e duhur. Ajo gjykatë nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për të interpretuar normën në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka analizuar se përse procesi gjyqësor përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues. Në këtë rast, gjykata referuese ka kërkuar interpretimin e normës ligjore nga Gjykata.

ii. *Për themelin*

6.2 Dispozita e kundërshtuar respekton *kriteret e nenit 17 të Kushtetutës,* pasi kufizimi është bërë me ligj, për sa kohë ndërhyrja është bërë në Kodin Rrugor, i cili referon te neni 291 i KP-së. Ky parashikim ligjor ka si qëllim sigurinë rrugore që është një interes publik, i cili, në rastin konkret, përfshin mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit të individëve, duke kufizuar aksesin në drejtimin e mjeteve të fuqishme nga persona që nuk kanë arritur moshën dhe pjekurinë e duhur. Parashikimi ligjor synon parandalimin e aksidenteve me pasoja fatale, të cilat në realitet ndodhin shpesh për shkak të mungesës së përvojës në drejtimin e motoçikletave të kategorisë A1. Duke e trajtuar shkeljen si vepër penale dhe jo vetëm si kundërvajtje administrative, rritet ndërgjegjësimi dhe përgjegjësia e drejtuesve të mjeteve. Drejtimi i motomjeteve nga persona që nuk plotësojnë kriterin e moshës dhe të përvojës përbën rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e individëve të tjerë. Gjykata referuese nuk ka arritur të evidentojë të drejtën ose lirinë kushtetuese, e cila është kufizuar në rastin konkret.

6.3 Dispozita e kundërshtuar nuk cenon *parimin e barazisë përpara ligjit, sipas nenit 18 të Kushtetutës,* pasi nuk ndodhemi përpara individëve në kushte të njëjta, siç e paraqet gjykata referuese, për sa kohë që personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe të përvojës në drejtimin e mjeteve motorike. Barazia përpara ligjit nuk nënkupton trajtim të barabartë për raste të ndryshme. Kodi Rrugor parashikon ndarje të drejtuesve të mjeteve sipas kategorive të ndryshme, në varësi të rrezikut dhe të aftësive të ndryshme dhe mosha 21 vjeç është vendosur për të mbrojtur sigurinë publike dhe jo për të diskriminuar drejtuesit e motomjeteve. Motomjetet përfaqësojnë vetëm 6% të numrit të përgjithshëm të mjeteve të regjistruara në vendin tonë, por shkalla e aksidenteve me viktima ose dëmtime serioze për këto mjete është shumë më e lartë se në kategoritë e tjera të mjeteve rrugore.

6.4 Dispozita e kundërshtuar është në përputhje dhe me *parimet e shtetit të së drejtës dhe me të drejtën për të mos u dënuar pa ligj,* sipas neneve 4 dhe 29 të Kushtetutës, pasi bazuar në përmbajtjen e saj rezulton se KP-ja ka parashikuar për gjyqtarin mundësinë e individualizimit të dënimit për veprën penale të kryer. Në rastin konkret, dispozita është e qartë, e parashikueshme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare për sigurinë rrugore dhe nuk ka një kriminalizim të paqartë ose të padrejtë, por një rregull të qartë për kriteret për drejtimin e mjeteve motorike dhe pasojat për mosrespektimin e tyre.

6.5 Dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me *parimin e prezumimit të pafajësisë,* sipas neneve 30 e vijues të Kushtetutës, për shkak se ajo nuk përjashton shqyrtimin gjyqësor, por përcakton një kriter objektiv, siç është mosha. Është gjykata ajo që do të shqyrtojë rrethanat e çështjes dhe që do të vendosë për (pa) fajësinë e individit. Fakti që një individ nuk plotëson kriteret për drejtimin e mjetit përkatës nuk do të thotë se dënohet automatikisht, por ai nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pa përmbushur kushtet e nevojshme, siç është plotësimi i moshës së kërkuar nga ligji. Mosplotësimi i moshës, i ndërthurur me elementet e anës objektive të figurës së veprës penale, nuk passjell dënimin e individit, por ai është subjekt i ndjekjes penale në bazë të ligjit.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e gjykatës referuese

7. Çështja e legjitimimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që mundëson fillimin e procesit kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental parashikohet në nenin 145, pika 2, të Kushtetutës, i cili u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur çmojnë se ligjet bien në kundërshtim

me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, të vendosin pezullimin e gjykimit të çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës për t'u shprehur për kushtetutshmërinë e normës. Kjo dispozitë, e konkretizuar edhe në nenin 68, të ligjit nr. 8577/2000, lidhet me kontrollin kushtetues të ligjeve nga Gjykata, kur ky kontroll kërkohet nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

8. Gjykata referuese ka parashtruar se plotëson kriteret e legjitimimit për nisjen e kontrollit incidental të pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën, pasi neni 291 i KP-së, që zbatohet në çështjen penale në shqyrtim përpara saj, referon drejtpërdrejt në shkronjën "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor dhe ka lidhje të drejtpërdrejtë me të, e cila po ashtu është e vetmja dispozitë që zbatohet në atë gjykim. Po kështu, gjykata referuese ka parashtruar se nuk ka asnjë mundësi që të bëhet interpretimi pajtues i dispozitës së kundërshtuar dhe se çështja e paraqitur për shqyrtim përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja konkrete e paraqitur për shqyrtim në Gjykatë.

9. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka pretenduar se gjykata referuese nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, pasi nuk ka parashtruar arsye të mjaftueshme bindëse dhe serioze për antikushtetutshmërinë e normës ligjore të kundërshtuar, por e ka paragjykuar atë, duke mos i dhënë kuptimin e duhur. Sipas këtij subjekti, gjykata referuese nuk i ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar normën ligjore në përputhje me Kushtetutën dhe nuk ka analizuar se përse procesi i paraqitur përpara saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi kushtetues, por, në thelb, ka kërkuar interpretimin e normës ligjore nga Gjykata.

10. Për sa i takon legjitimimit të gjykatës referuese që vë në lëvizje kontrollin incidental të kushtetutshmërisë së normës ligjore, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, të konkretizuar në nenin 68, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka zhvilluar disa kritere kumulative, sipas të cilave gjykata referuese duhet që gjatë gjykimit që zhvillohet pranë saj: i. të ketë identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e tij dhe të ketë krijuar bindjen se gjykimi i saj nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga çështja në Gjykatë, pra lidhjen e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe çështjes kushtetuese; ii. të ketë parashtruar arsye bindëse për antikushtetutshmërinë e ligjit, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii. të ketë bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 32, datë 30.5.2023; nr. 8, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Lidhur me këto kritere legjitimimi, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se gjykata referuese duhet të arsyetojë efektin e drejtpërdrejtë që ka dispozita e kundërshtuar për gjykimin pranë saj, duke individualizuar se pikërisht ajo dispozitë zbatohet dhe zgjidh mosmarrëveshjen konkrete pranë saj. Dispozita e kundërshtuar duhet të ketë lidhje me gjykimin në gjykatën referuese në atë masë që ai nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur pa u shqyrtuar nga Gjykata kushtetutshmëria e dispozitës ligjore (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 30, datë 2.11.2022; nr. 30, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Po kështu, Gjykata ka theksuar se përpara marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të konkludojë se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës. Për këtë arsye, kërkohet një raport i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës (zgjidhjes së çështjes të kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 73, datë 17.11.2017; nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, gjykata referuese duhet të evidentojë jo vetëm objektin, por edhe standardin kushtetues të cenuar në funksion të vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues, pra jo vetëm normën ligjore, por edhe parimet ose standardet kushtetuese që ajo cenon në rast se zbatohet për zgjidhjen e çështjes (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 8, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për sa i përket kriterit të përpjekjeve për interpretimin e dispozitës në përputhje me Kushtetutën, Gjykata ka theksuar se është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese (*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 5, datë 16.2.2012; nr. 29, datë 31.5.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm në rast se gjykata referuese vlerëson se çdo interpretim i mundshëm bie në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë duhet t'i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si të zbatueshme në rastin konkret

(*shih vendimet nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 69, datë 27.12.2023; nr. 4, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se gjykata referuese është vënë në lëvizje për shqyrtimin e kërkesës së Prokurorisë së Korçës për dërgimin në gjyq të çështjes penale nr. 900/2024, me të pandehur shtetasin T. B., të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i KP-së. Ai shtetas, i moshës 20 vjeç, nën drejtimin e motomjetit të tij, me të cilin punonte, është përplasur me një mjet tjetër. Mjeti i cili drejtohej nga shtetasi T. B., sipas dokumentacionit të administruar në dosje, bën pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që ai (shtetasi T. B.) në momentin e shkaktimit të aksidentit ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B. Sipas shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor "*Lejedrejtimi e kategorisë B është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kw, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç*". Nga verifikimi i akteve ka rezultuar se shtetasi T. B. në momentin e aksidentit ishte 20 vjeç, për rrjedhojë në atë kohë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit për mjetin të cilin drejtonte.

15. Gjykata, referuar rrethanave të çështjes në shqyrtim dhe arsyetimit të vendimit të gjykatës referuese për pezullimin e gjykimit përpara saj dhe referimin e çështjes së kushtetutshmërisë, konstaton se dispozita penale e zbatueshme në rastin konkret është neni 291 i KP-së, paragrafi i parë i të cilit "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet",* referon te shkronja "ë", e pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor, objekti i kërkesës në shqyrtim. Në këtë rast, duke mbajtur parasysh se shkaqet e kërkesës lidhen me antikushtetutshmërinë e dispozitës së Kodit Rrugor, e identifikuar nga gjykata referuese si e zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete, për shkak të referimit që bën në të norma penale që parashikon veprën penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, si dhe analizën e kësaj të fundit për pamundësinë e interpretimit të normës në përputhje me Kushtetutën, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, janë plotësuar kriteret e legjitimimit në drejtim të identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes që ka me çështjen e paraqitur për shqyrtim përpara gjykatës referuese, në kuptim të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 68, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj prapësimi i subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, në këtë drejtim është i pabazuar.

16. Për sa i përket kriterit të parashtrimit të arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, Gjykata konstaton se gjykata referuese, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, duke argumentuar se, në rastin konkret, ligji e parashikon si krim kushtin e mospasjes së moshës të paktën 21 vjeç, për të drejtuar motomjete të kategorisë A1 dhe të pandehurit nuk i jepet mundësia të provojë mungesën e çdo rrezikshmërie të mundshme penale në veprimet e tij dhe për pasojë edhe faktin që nuk ka vepër penale.

17. Në rastin konkret, për këtë pretendim të gjykatës referuese, referuar argumenteve të saj në këtë drejtim, Gjykata vëren se ajo nuk ka arritur të provojë sesi dispozita objekt kërkese e ka cenuar këtë parim. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk ka paraqitur argumente kushtetuese në mbështetje të këtij pretendimi të saj.

18. Po kështu, gjykata referuese ka pretenduar se dispozita objekt kërkese ka cenuar edhe *parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve*, pasi, sipas saj, ligjvënësi u ka hequr mundësinë gjykatave të vlerësojnë nëse ka ose jo vepër penale referuar rrethanave konkrete të ngjarjes të sjellë si fakt penal nga organi i akuzës dhe ato (gjykatat) janë të detyruara që të shpallin fajtor të pandehurin vetëm me vërtetimin e mosplotësimit të kushtit të moshës 21 vjeç, pa provuar (mos) aftësinë e tij në drejtimin e motomjetit.

19. Sipas Gjykatës, parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, i parashikuar në nenin 7 të Kushtetutës, sanksionon se ligjvënësi, ekzekutivi dhe gjyqësori janë të ndarë, efektivisht të pavarur dhe midis tyre duhet të ketë një balancë. Në përputhje me detyrat që u ka ngarkuar Kushtetuta, secili prej tyre është i pajisur me pushtet të mjaftueshëm, gjë që i jep mundësinë të marrë vendime në mënyrë të lirë e të pavarur dhe asnjë organ ose institucion tjetër, në përbërje ose jo të njërit prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve, që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve ose të institucioneve të tjera kushtetuese *(shih vendimet nr. 36, datë 1.6.2015; nr. 16, datë 10.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

20. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe i llojeve të dënimeve janë në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimin nr. 47, datë 27.6.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata, bazuar në parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, të parashikuar nga neni 7 i Kushtetutës, si dhe në përmbajtjen e nenit 29 të saj, vlerëson se në procesin penal caktimi i veprave penale dhe i dënimeve të tyre është në diskrecion të pushtetit ligjvënës, ndërsa gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në kontekstin e funksionit kushtetues të ushtrimit të pushtetit gjyqësor në procesin penal, kanë detyrën të identifikojnë veprën penale të kryer, si dhe të individualizojnë dënimin brenda kufijve minimalë dhe maksimalë të përcaktuar nga ligjvënësi për veprën konkrete penale.

22. Gjykata vëren se KP-ja, në nenin 47 të saj, ka përcaktuar se individualizimi i dënimit është përcaktimi ndërmjet një minimumi dhe një maksimumi të ofruar nga ky kod dhe zbatimi i kësaj mase brenda kufijve të parashikuar në ligj dhe në përshtatje me karakterin e shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj, si dhe shkallën e fajësisë, duke pasur parasysh rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat, në mënyrë më efikase, do të ndikonin në riedukimin e autorit të veprës penale, çka do të thotë përshtatja e dënimit të veprës penale dhe kryerësit të saj. Në këtë kuptim, neni 291 i KP-së ka parashikuar se drejtimi i automjeteve ose i mjeteve të tjera të motorizuara pa dëshminë përkatëse dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet dhe gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.

23. Për sa më lart, Gjykata vëren se, ndryshe nga sa pretendon gjykata referuese, ligjvënësi u ka dhënë mundësinë gjykatave që duke u referuar te dispozitat përkatëse të Kodit Rrugor të vlerësojnë nëse personi i cili drejton një mjet pa dëshminë përkatëse, ka kryer një vepër penale dhe të shpallet fajtor ose jo për kryerjen e saj, si dhe të individualizojnë dënimin për veprën penale të kryer. Për këtë arsye, Gjykata çmon se dispozita objekt kërkese nuk cenon thelbin e së drejtës të gjykatave në vlerësimin nëse ka ose jo vepër penale dhe në individualizimin e dënimit për veprën konkrete penale të kryer. Për rrjedhojë, në drejtim të detyrimit për parashtrimin e arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e dispozitës së kundërshtuar, argumentet e gjykatës referuese në drejtim të cenimit të parimit të ndarjes dhe të balancimit të pushteteve janë haptazi të pabazuara.

24. Për sa u përket pretendimeve të tjera të gjykatës referuese, Gjykata vëren se ajo ka arritur të evidentojë standardet/parimet kushtetuese të pretenduara të cenuara prej normës së kundërshtuar, duke sjellë argumente konkrete në këtë drejtim, të cilat janë të mjaftueshme në kontekstin e vlerësimit *prima facie* të legjitimimit. Në këtë drejtim, Gjykata konstaton se sipas gjykatës referuese dispozita objekt kërkese bie në kundërshtim me Kushtetutën, pasi ajo cenon lirinë e lëvizjes, të drejtën për punë, parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, parimin e shtetit të së drejtës dhe të drejtën për t'u mos u dënuar pa ligj. Gjykata, duke mbajtur parasysh natyrën dhe përmbajtjen e argumenteve të parashtruara në mbështetje të këtyre pretendimeve, vlerëson se ato, në thelb, kanë të bëjnë me parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, ndaj, në vijim, do të shqyrtojë çështjen në themel në këtë drejtim.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimit

25. Gjykata referuese ka pretenduar se dispozita, objekt i këtij gjykimi kushtetues, trajton në mënyrë të pabarabartë drejtuesit e motomjeteve me drejtuesit e mjeteve të tjera dhe nuk ka përputhshmëri me legjislacionin evropian. Sipas saj, ky parashikim ligjor përbën një diskriminim të paarsyeshëm dhe nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së

drejtimit të kategorisë B, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Sipas gjykatës referuese, në këtë rast, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji. Nga relacionet që kanë shoqëruar ndryshimet në Kodin Rrugor nuk jepet asnjë shpjegim se përse është vendosur ky kufizim moshe, edhe pse rreziku eventual dhe potencial është i njëjtë si për personat e aftë që njohin rregullat e qarkullimit rrugor dhe që drejtojnë mjetet me lejen përkatëse, ashtu edhe për ata që nuk kanë lejen përkatëse të drejtimit, por një leje tjetër, të cilët po ashtu janë njësoj të aftë fizikisht e mendërisht t'i drejtojnë ato mjete njësoj si personat që kanë lejen përkatëse. Gjykata referuese ka pretenduar se ligjvënësi nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë në ligjin penal dhe në përgjegjësinë penale që mbajnë personat që kanë rrezikshmëri të njëjtë shoqërore në veprimet që kryejnë.

26. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me nenin 18 të Kushtetutës dhe se në rastin konkret ndodhemi përpara individëve në kushte të ndryshme e jo përpara individëve në kushte të njëjta, siç paraqitet nga gjykata referuese. Sipas Këshillit të Ministrave, personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe të përvojës në drejtimin e mjeteve motorike. Në vlerësimin e këtij subjekti, Kodi Rrugor parashikon ndarje të drejtuesve të mjeteve sipas kategorive të ndryshme, në varësi të rrezikut dhe të aftësive të ndryshme dhe mosha 21 vjeç është vendosur për të mbrojtur sigurinë publike dhe jo për diskriminim. Po kështu, Këshilli i Ministrave ka argumentuar se motomjetet përfaqësojnë vetëm 6% të numrit të përgjithshëm të mjeteve të regjistruara në vendin tonë, por shkalla e aksidenteve me viktima ose dëmtime serioze për këto mjete është shumë më e lartë se në kategoritë e tjera të mjeteve rrugore. Po sipas Këshillit të Ministrave, parashikimi ligjor ka si qëllim sigurinë rrugore dhe synon parandalimin e aksidenteve me pasoja fatale, të cilat në realitet ndodhin shpesh për shkak të mungesës së përvojës në drejtimin e motoçikletave të kategorisë A1, pasi drejtimi i motomjeteve nga persona që nuk plotësojnë kriterin e moshës dhe të përvojës përbën rrezik të drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tyre, si dhe të individëve të tjerë.

27. Kushtetuta në nenin 18 të saj parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Kjo dispozitë, në paragrafin e dytë, sanksionon ndalimin e diskriminimit, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, por vetëm nëse ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive. Parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Barazia në ligj dhe përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 27, datë 29.6.2021; nr. 10, datë 29.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për të vlerësuar nëse një akt normativ është diskriminues, Gjykata shqyrton nëse ai parashikon trajtim të diferencuar të subjekteve dhe në rast se e konstaton këtë fakt, ajo vlerëson nëse diferencimi ka qenë i përligjur dhe për një arsye objektive. Kjo përligjje vlerësohet e lidhur me qëllimet dhe efektet e masave të marra. Gjithashtu, nuk mjafton vetëm diferencimi i përligjur, por duhet edhe që mjeti i përzgjedhur për arritjen e qëllimit të ligjvënësit të jetë i arsyeshëm dhe i përshtatshëm. Veçanërisht për sa u takon mjeteve të përdorura, ato duhet të jenë efektive, pra të zgjedhura në mënyrë të tillë që të jenë të përshtatshme për realizimin e synimeve që ndiqen. Respektimi i këtyre kushteve kërkon një analizë të kujdesshme në çdo rast konkret, duke ballafaquar interesin publik që dikton diferencimin e përligjur dhe arsyen objektive (*shih vendimet nr. 35, datë 15.6.2023; nr. 34, datë 10.4.2017; nr. 33, datë 8.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në kuptim të këtyre standardeve, Gjykata edhe në rastin konkret do të verifikojë nëse ligjvënësi ka parashikuar një trajtim të diferencuar mes subjekteve që ndodhen në kushte të njëjta, siç pretendohet nga gjykata referuese, dhe nëse një

trajtim i tillë nuk respekton kriteret kushtetuese që e lejojnë atë.

30. Gjykata vëren se sipas nenit 114 të Kodit Rrugor, cilido që drejton mjete rrugore, krahas plotësimit të kërkesave fizike e psikike dhe testit psikofizik, duhet të mbushë edhe moshën e caktuar, që përcaktohet në varësi të mjetit që kërkohet të drejtohet. Për sa u përket mjeteve me motor të kategorive A1, A2, B1 dhe B, dispozita parashikon se kushdo që kërkon të drejtojë një mjet të tillë duhet të ketë mbushur moshën 18 vjeç (*pika 1, shkronja "c"*). Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se sipas kësaj dispozite mosha minimale për t'u pajisur me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe kategorisë A1 është 18 vjeç. Mjetet e kategorisë B dhe kategorisë A1 janë përcaktuar në nenin 115, pika 3, të Kodit Rrugor që parashikon ndarjen e lejedrejtimit sipas kategorive dhe aftësive në drejtimin e mjeteve, ku specifikisht kategoria A1 përfshin motomjetet me cilindratë jo më shumë se 125 centimetër kub dhe me fuqi jo më shumë se 11 kw dhe me raportin fuqi/peshë jo më shumë se 0,1 kw/kg, si dhe triciklat me një fuqi jo më të madhe se 15 kw, ndërsa, kategoria B përfshin mjetet motorike me masë maksimale të autorizuar jo më të madhe se 3 500 kg dhe me jo më shumë se 8 ndenjëse, përjashtuar ndenjësen e drejtuesit të mjetit. Mjetet e kësaj kategorie (B) mund të tërheqin një rimorkio të lehtë ose një gjysmërimorkio që nuk e kalon masën maksimale të autorizuar 750 kg, duke u siguruar që masa maksimale e autorizuar e këtij kombinimi të mos kalojë 4 250 kg. Në rast se kombinimi i kalon 3 500 kg, drejtuesi duhet t'i nënshtrohet një trajnimi dhe provimi të posaçëm.

31. Neni 123 i Kodit Rrugor që përcakton periudhat dhe njëvlershmëritë midis kategorive të lejedrejtimit, në pikën 2, shkronja "ë", ka parashikuar se lejedrejtimi i kategorisë B është i vlefshëm në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kW, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën i moshës 21 vjeç. Referuar kësaj dispozite, objekt i gjykimit kushtetues, Gjykata vëren se mjetet rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kw, si dhe motomjetet e kategorisë A1 mund të drejtohen vetëm nga personat e pajisur me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe vetëm nëse kanë mbushur moshën 21 vjeç. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se, si rregull të përgjithshëm, Kodi Rrugor parashikon moshën minimale 18 vjeç për pajisjen me leje drejtimi për kategorinë B, ndërkohë që brenda kësaj kategorie ka kushtëzuar drejtimin e disa lloj mjetesh (motomjetet e kategorisë A1) edhe me mbushjen e moshës 21 vjeç. Për rrjedhojë, personat të cilët pajisen me leje drejtimi të kategorisë B pas mbushjes së moshës 18 vjeç kanë të drejtën që të drejtojnë mjetet e tjera që përfshihen në kategorinë përkatëse pa pasur ndonjë kufizim tjetër, siç është mosha në këtë rast. Në këtë mënyrë, Gjykata konstaton se dispozita e kundërshtuar ka bërë një trajtim të diferencuar ndërmjet personave të pajisur me të njëjtën leje drejtimi, ajo e kategorisë B, duke parashikuar për disa lloje motomjetesh një kriter të shtuar për drejtimin e tyre, që është mosha 21 vjeç. Për rrjedhojë, Gjykata, në vijim, do të vlerësojë nëse në rastin konkret ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive që justifikon këtë trajtim të diferencuar brenda së njëjtës kategori të individëve.

32. Gjykata vëren se kategoritë e mjeteve rrugore janë përcaktuar në nenin 115 të Kodit Rrugor, i cili i ka ndarë ato sipas tipologjisë, kategorisë, shpejtësisë, madhësisë, fuqisë ose peshës, të kombinuara këto elemente me njëri-tjetrin. Gjithashtu, Gjykata konstaton se përveç kufizimit të lidhur me moshën të vendosur në dispozitën e kundërshtuar, ky kod parashikon edhe kufizime të tjera për dhënien e lejeve të drejtimit për disa kategori të caktuar personash, bazuar në gjendjen fizike, shëndetësore, mendore, ose moshës, apo eksperiencës, duke i lidhur këto me tipologjinë, kategorinë, shpejtësinë, madhësinë, fuqinë ose peshën e mjeteve.

33. Kështu, sipas Kodit Rrugor, cilido që drejton mjete me motor nuk duhet të ketë kaluar moshën 70 vjeç për të drejtuar autobusë, kamionë, kamionë me rimorkio, gjysmërimorkiatorë, artikularë të tjerë, të caktuar për transport personash dhe mjete me motor për transport malli (*neni 114, pika 2*). Në dispozitat vijuese, Kodi Rrugor ka përcaktuar edhe dhënien e lejeve të drejtimit për personat me aftësi të kufizuara, si dhe certifikatat e aftësisë profesionale për drejtimin e motomjeteve dhe të automjeteve për to, duke e kufizuar dhënien e tyre vetëm për disa kategori të caktuara mjetesh (*neni 115/1*), si dhe ka ndaluar pajisjen me leje drejtimi dhe/ose autorizim për t'u ushtruar në drejtim mjeti për personat e prekur nga sëmundje fizike apo çrregullime të shëndetit mendor, ose për ata që kanë paaftësi

anatomike ose funksionale, të tilla që e pengojnë të drejtojë në mënyrë të sigurt një mjet me motor (*neni 117, pika 1*). Po kështu, Gjykata vëren se Kodi Rrugor ka përcaktuar edhe kufizime të tjera në varësi të përvojës së individëve në drejtimin e mjeteve, duke parashikuar se disa kategori mjetesh mund të drejtohen nga zotëruesit e një lejeje drejtimi të caktuar, vetëm pasi kanë kaluar një, dy ose tre vjet nga marrja e saj (*nenet 117/1, pikat 1 dhe 1/1, dhe 123, pika 1, shkronjat: "c", "ç" dhe "d"*).

34. Sipas Kodit Rrugor, zotëruesve të lejedrejtimeve vendase të grupit "A" për tre vjetët e para pas marrjes së lejedrejtimit nuk u lejohet drejtimi i motomjeteve me fuqi prej 25 kw specifike referuar ngarkesës, ose 0,16 kw/kg (*neni 117/1, pika 1*). Ndërsa mbajtësve të lejeve të drejtimit të kategorisë B, në dy vjetët e para të lëshimit, nuk u lejohet të drejtojnë mjete motorike me fuqi specifike, referuar masës bosh të mjetit, më të madhe se 55 kw/tonë. Për makinat hibride elektrike ose plug-in, kufiri specifik i fuqisë është 65 kw/tonë, duke përfshirë peshën e baterisë (*neni 117/1, pika 1/1*). Një tjetër kufizim që parashikon Kodi Rrugor për pajisjen me lejedrejtimi është edhe ai i përcaktuar në nenin 123, pika 1, shkronja "ç", paragrafët e dytë dhe të tretë, sipas të cilëve mosha minimale për t'u pajisur me lejedrejtimi D1 dhe lejedrejtimi D1E është 21 vjeç, ndërsa për pajisjen me lejedrejtimi të kategorisë D është 24 vjeç, lejedrejtimi për të cilat mund të aftësohen vetëm personat e pajisur me leje drejtimi të kategorisë B, të marrë përkatësisht prej 3 vjetësh ose 12 muajve. Nga ana tjetër, referuar edhe parashikimeve të akteve të zbatueshme për përgatitjen dhe pajisjen me lejedrejtimi, rezulton se programi dhe prova e praktikës për pajisjen me lejedrejtimi të kategorisë A1 dhe të kategorisë B janë të ndryshme.

35. Gjykata vëren se neni 123 i Kodit Rrugor në kohën e miratimit të tij nuk parashikonte ndonjë kusht të posaçëm për drejtimin e motomjeteve brenda së njëjtës kategori. Me ligjin nr. 175/2014, datë 18.12.2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, 'Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë', të ndryshuar", ligjvënësi ka ndryshuar edhe përmbajtjen e nenit 123 të Kodit Rrugor, duke shtuar edhe shkronjën "ë", në pikën 2 të këtij neni, sipas formulimit aktual. Edhe pse ky kod ka pësuar ndryshime të tjera gjatë viteve, kjo dispozitë ka mbetur e njëjtë në formulim. Gjykata konstaton se sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, vendosja e këtij kriteri moshe (mbushja e moshës 21 vjeç), ka qenë një kusht i parashikuar nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

36. Gjykata, referuar direktivës 2006/126/EC "Për lejet e drejtimit" të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, vëren se sipas saj triciklat me një fuqi më të madhe se 15 kw mund të drejtohen nga personat të cilët janë të pajisur me leje drejtimi të kategorisë B, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë të paktën i moshës 21 vjeç. Ndërsa për mjetet e kategorisë A1 direktiva parashikon se ato mund të drejtohen nga mbajtësit e lejedrejtimit të kategorisë B (*neni 6, pika 3, i direktivës*).

37. Më tej, nga një vështrim i përgjithshëm krahasimor i legjislacionit të brendshëm të disa shteteve evropiane, Gjykata vëren se Kodi Rrugor italian nuk ka parashikuar asnjë kusht shtesë nga ato të parashikuara nga direktiva. Ndryshe ka vepruar Spanja, e cila në legjislacionin e saj ka parashikuar kushte shtesë vetëm për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, duke përcaktuar mbajtjen e lejes së drejtimit të kategorisë B për të paktën 3 vjet. Edhe Austria edhe Gjermania kanë transpozuar variantin e direktivës me kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, duke parashikuar se ato mund të drejtohen nga mbajtësit e lejeve të drejtimit të kategorisë B, pas kalimit të një periudhe prej pesë vjetësh (pa ndërprerje në rastin e Austrisë) nga mbajtja e leje drejtimit të kategorisë B. Në këtë rast, Gjermania ka vendosur edhe kushtin e mbushjes së moshës 25 vjeç dhe realizimit të trajnimit të detyrueshëm, ndërsa Austria ka vendosur kushtin e mosqenies në periudhë prove dhe përfundimit të trajnimit praktik në drejtimin e këtyre mjeteve. Franca lejon drejtuesin e pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B të drejtojë edhe mjete rrugore me tre rrota me fuqi më të madhe se 15 kw, por përveç mbushjes së moshës minimale 21 vjeç që parashikon direktiva, ka vendosur edhe dy kushte të tjera shtesë që janë përvoja të paktën dyvjeçare me lejen e drejtimit të kategorisë B dhe detyrimi për trajnim praktik, duke vendosur një standard më të rreptë në nivel kombëtar. Ndërsa shtete si Holanda dhe Greqia kanë mbajtur ndarje të plotë midis lejeve të drejtimit të kategorisë B dhe kategorisë A1, ku drejtimi i mjeteve me tre rrota mbi 15 kw ose i motomjeteve të kategorisë A1 kërkon pajisje të veçantë me kategori të re lejedrejtimi.

38. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vëren se direktiva e BE-së, ashtu edhe legjislacioni i disa

shteteve evropiane, si më sipër, sjellin qasje të ndryshme, ku në disa prej tyre nuk janë parashikuar kushte shtesë përveç atyre që parashikon direktiva, kurse në legjislacionet e tjera gjenden të parashikuara kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, të cilat kanë të bëjnë me arritjen e një moshe të caktuar ose me përvojën në drejtimin e një kategorie të caktuar mjeti, në të njëjtën mënyrë siç ka vepruar ligjvënësi shqiptar.

39. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përkufizimi i një rregullimi juridik, nëse është ose jo *objektivisht* i arsyetuar, nuk është vetëm një çështje e thjeshtë juridike, por kërkon edhe një vlerësim real. Diferencimet, si dhe arsyet që çojnë tek to ose kundër tyre duhen ballafaquar për t'ia lënë në dorë përfundimisht vendimin organit kompetent, sipas kritereve të tij. Mënyra e zgjidhjes është një e drejtë e organit përkatës, sepse çdo çështje ka specifikat e saj. Ndodhemi përpara diskriminimit kur subjekte juridike që ndodhen në të njëjtën gjendje trajtohen në mënyra të ndryshme pa justifikim ligjor të arsyeshëm dhe objektiv. Natyrisht që përkufizimi i çdo kriteri për ta cilësuar arsyetimin *objektiv* varet në një masë të madhe nga çmuarja e vlerave dhe nuk mund të jetë i përcaktuar në mënyrë precize *(shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 48, datë 15.11.2013; nr. 4, datë 12.2.2010, të Gjykatës Kushtetuese)*.

40. Gjykata vëren se, bazuar në argumentet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, rezulton se kushti i moshës 21 vjeç në dispozitën objekt gjykimi është vendosur për shkak të numrit të lartë të aksidenteve me viktima ose dëmtimeve serioze nga këto mjete, në krahasim me ato të shkaktuara nga mjetet rrugore të kategorive të tjera, pra për një interes publik, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rrugore dhe në këtë rast përfshin jo vetëm mbrojtjen e jetës, por dhe shëndetin dhe sigurinë fizike të individëve. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se ky interes publik lidhet edhe me mbrojtjen e të rinjve, pasi përmes këtij parashikimi ligjor synohet të parandalohen pasojat e përdorimit të këtyre mjeteve me rrezikshmëri të lartë nga personat që konsiderohen se nuk kanë moshën dhe pjekurinë e duhur për drejtimin e tyre. Gjykata vlerëson të theksojë se edhe sipas nenit 54 të Kushtetutës të rinjtë kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti, që reflektohet edhe në marrjen e masave me natyrë pozitive për t'i mbrojtur ata edhe nga veprime që mund të sjellin pasoja për jetën dhe të ardhmen e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Po kështu, edhe KP-ja ka ofruar në vazhdimësi një mbrojtje të veçantë për të rinjtë e moshës deri në 21 vjeç, duke i përfshirë ata në subjektet që përfitojnë nga alternativat e dënimit me burgim (*neni 59/"a", paragrafi i parë, shkronja "d"*).

41. Nisur nga sa më lart, Gjykata, duke pasur parasysh vlerat dhe interesat që vihen në diskutim, në rastin konkret, çmon se parashikimi ligjor i shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor edhe pse përbën një trajtim të diferencuar mes subjekteve që përfshihen brenda së njëjtës kategori, pra që kanë lejedrejtimi të kategorisë B, ka një justifikim ligjor të arsyeshëm, objektiv dhe të justifikuar. Pavarësisht se dispozita ligjore e kundërshtuar përmes këtij gjykimi incidental diferencon në trajtim personat që janë të pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, në varësi të natyrës, karakteristikave dhe sigurisë që ofron mjeti rrugor që drejtohet prej tyre, duke ndaluar përdorimin e motomjeteve të kategorisë A1, në rast se nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, ndonëse e kanë mbushur atë për pajisjen me lejedrejtimi, qëllimi që synohet të arrihet është jo vetëm siguria rrugore në drejtimin e mjeteve rrugore, por edhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të qytetarëve, sidomos e vet të rinjve që mund të përdorin këto mjete. Gjykata konstaton se ligjvënësi, duke parashikuar një kufi moshe minimale për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, që është tre vjet më i lartë se kufiri minimal për drejtimin e mjeteve të kategorisë B, ka synuar të rrisë jo vetëm nivelin e maturisë në vlerësimin dhe shmangien e rrezikut të mundshëm në qarkullim, por edhe eksperiencën 1-3 vjeçare për ata që e kanë marrë lejen e drejtimit të kategorisë A1 në kufirin e moshës minimale ose afër tij (18–21 vjeç). Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se në rastin konkret kjo ndërhyrje e ligjvënësit ka pasur një përligjje të arsyeshme, të përshtatshme dhe objektive, ndaj pretendimi i gjykatës referuese është i pabazuar.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, nga përmbajtja e nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të Kodit Rrugor, nuk është i bazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "a" dhe 134, pika 1, shkronja "dh", të Kushtetutës, si dhe neneve 68, 70, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.9.2025.

Shpallur më 27.10.2025.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Genti Ibrahimi, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtare kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkueses, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, me objekt: "*Shfuqizimin e nenit 123, pika 2, shkronja "ë", të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*", jam kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës dhe vlerësoj se ajo duhej të ishte pranuar, për shkak se dispozita e kundërshtuar cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, të parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës. Për këtë arsye, në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, në vijim do të parashtroj argumentet që mbështesin qëndrimin tim kundër.

2. Sipas rrethanave të rastit konkret, të parashtruara edhe nga shumica, ka rezultuar se shtetasi T. B., gjatë drejtimit të motomjetit të tij është përplasur me një automjet, duke shkaktuar aksident. Nga verifikimi i kryer ka rezultuar se mjeti i drejtuar nga shtetasi T. B. bënte pjesë në kategorinë A1 të motomjeteve, ndërkohë që ai ka qenë i pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, e cila, sipas shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor *"është e vlefshme në territorin kombëtar për të drejtuar mjete rrugore me tri rrota, me fuqi më të madhe se 15 kw, si dhe motomjetet e kategorisë A1, me kusht që mbajtësi i lejedrejtimit të jetë, të paktën, 21 vjeç*". Nga verifikimi i drejtuesit të mjetit, shtetasi T. B., ka rezultuar se ishte i moshës 20 vjeç, për rrjedhojë nuk ka pasur lejen përkatëse të drejtimit, Prokuroria e Korçës ka regjistruar ndaj tij procedimin penal për kryerjen e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i KP-së, i cili parashikon se "*drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara [...] pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet*". Në vijim, Prokuroria e Korçës ka paraqitur në gjykatën referuese kërkesë për dërgimin e kësaj çështjeje në gjyq. Nga ana e saj, gjykata referuese, pas kërkesës së palëve, ka vendosur të pezullojë gjykimin e çështjes në shqyrtim përpara saj dhe t'i drejtohet Gjykatës me kërkesë për shfuqizimin e shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 123 të Kodit Rrugor.

3. Në vlerësimin e kërkueses, gjykatës referuese, ky përcaktim i dispozitës së kundërshtuar bie në kundërshtim me parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit, pasi përbën një diskriminim të paarsyeshëm dhe nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive për kufizimin e drejtimit të motomjeteve me moshën 21 vjeç, në kushtet kur drejtuesit e motomjeteve i nënshtrohen të njëjtit testim për marrjen e lejes së drejtimit të kategorisë B, njohin mirë rregullat e qarkullimit rrugor dhe dëshmojnë se kanë aftësi shumë të mira drejtuese edhe për drejtimin e motomjeteve të kategorisë A1. Sipas gjykatës referuese, në këtë rast, personat që janë në kushte të njëjta trajtohen ndryshe nga ligji.

4. Ndërkohë ky pretendim i gjykatës referuese është kundërshtuar nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, sipas të cilit dispozita e kundërshtuar është në përputhje edhe me nenin 18 të Kushtetutës dhe, se në rastin konkret ndodhemi përpara individëve në kushte të ndryshme e jo përpara individëve në kushte të njëjta. Sipas Këshillit të Ministrave, personat nën moshën 21 vjeç ndodhen në kushte objektivisht të ndryshme nga ata mbi moshën 21 vjeç, për shkak të njohurive dhe përvojës në drejtimin e mjeteve motorike.

5. Në shqyrtimin e pretendimeve dhe të prapësimeve të mësipërme, shumica ka vlerësuar se, bazuar në argumentet e subjektit të interesuar,

Këshillit të Ministrave, rezulton se kushti i moshës 21 vjeç në dispozitën objekt gjykimi është vendosur për shkak të numrit të lartë të aksidenteve me viktima ose dëmtimeve serioze nga këto mjete, në krahasim me ato të shkaktuara nga mjetet rrugore të kategorive të tjera, pra për një interes publik, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë rrugore dhe në këtë rast përfshin jo vetëm mbrojtjen e jetës, por edhe shëndetin edhe sigurinë fizike të individëve. Nga ana tjetër, shumica ka konstatuar se ky interes publik lidhet edhe me mbrojtjen e të rinjve, pasi përmes këtij parashikimi ligjor synohet të parandalohen pasojat e përdorimit të këtyre mjeteve me rrezikshmëri të lartë nga personat që konsiderohen se nuk kanë moshën dhe pjekurinë e duhur për drejtimin e tyre, duke referuar në nenin 54 të Kushtetutës *(shih paragrafin 40 të vendimit*). Po sipas shumicës, edhe pse parashikimi ligjor i shkronjës "ë" të pikës 2 të nenit 123 të Kodit Rrugor përbën një trajtim të diferencuar mes subjekteve që përfshihen brenda së njëjtës kategori, pra që kanë lejedrejtimi të kategorisë B, ka një justifikim ligjor të arsyeshëm, objektiv dhe të justifikuar. Po kështu, shumica ka vlerësuar se pavarësisht se dispozita ligjore e kundërshtuar përmes këtij gjykimi incidental diferencon në trajtim personat që janë të pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B në varësi të natyrës së mjetit rrugor që drejtohet nga ata, duke ndaluar përdorimin e motomjeteve të kategorisë A1, në rast se nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, ndonëse kanë mbushur atë për pajisjen me lejedrejtimi, qëllimi që synohet të arrihet, është jo vetëm siguria rrugore në drejtimin e mjeteve rrugore, por edhe mbrojtja e jetës dhe e shëndetit të qytetarëve, sidomos të vet të rinjve që mund të përdorin këto mjete (*shih paragrafin 41 të vendimit*).

6. Ndërkohë, në rastin konkret, është konstatuar se nga subjekti i interesuar, Kuvendi, si organi i cili ka miratuar Kodin Rrugor, pra dispozitën e kundërshtuar nga gjykata referuese, nuk u paraqit asnjë argument për nevojën e miratimit të saj ose referenca konkrete për bazueshmërinë e kësaj dispozite ligjore dhe as arsye se përse kjo dispozitë parashikon një kusht shtesë, mbushjen e moshës 21 vjeç për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, kur për t'u pajisur me këtë kategori lejedrejtimi qytetarët mjafton të kenë mbushur moshën 18 vjeç. Po kështu, as nga subjekti tjetër i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk u paraqitën argumente bazuar në të dhëna statistikore se përse vendosja e këtij kushti shtesë për personat e pajisur me lejedretimi të kategorisë B mbron interesin publik, duke rritur sigurinë rrugore dhe duke mbrojtur në këtë mënyrë edhe interesin publik. Në këtë gjykim kushtetues, nga subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, nuk u paraqit asnjë argument se përse personat e pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, të cilët nuk kanë mbushur moshën 21 vjeç, nuk janë të aftë të drejtojnë mjetet e kategorisë A1, si dhe nuk u arrit të provohej nëse ky diferencim sillte mbrojtje më të madhe për sigurinë rrugore, shëndetin dhe jetën e qytetarëve, duke mbrojtur interesin publik.

7. Për këto arsye, ndryshe nga shumica, çmoj se ky parashikim ligjor, duke sjellë një diferencim ndërmjet personave të pajisur me lejedrejtimi të kategorisë B, për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, nuk ka një përligjje të arsyeshme dhe objektive, në drejtim të garantimit të sigurisë në drejtimin e mjeteve rrugore dhe as në drejtim të mbrojtjes së jetës dhe të shëndetit të qytetarëve. Në vlerësimin tim, edhe pse legjislacioni i disa shteteve evropiane ka parashikuar kushte shtesë për drejtimin e mjeteve të kategorisë A1, përveç atyre të përcaktuara nga direktiva 2006/126/EC, "Për lejet e drejtimit" të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, sipas së cilës mjetet e kategorisë A1 mund të drejtohen nga mbajtësit e lejedrejtimit të kategorisë B (*neni 6, pika 3, i direktivës*), pa parashikuar asnjë kusht tjetër shtesë, nuk përbën arsye të përligjur për të diferencuar subjektet që përfshihen brenda së njëjtës kategori.

8. Për rrjedhojë, jam e mendimit se pretendimi i gjykatës referuese se dispozita objekt kërkese cenon parimin e barazisë përpara ligjit dhe të mosdiskriminimit është i bazuar dhe duhej pranuar nga Gjykata.

Anëtare: Sonila Bejtja

VENDIM
Nr. 65, datë 24.10.2025

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;

Genti Ibrahimi anëtar;
Marjana Semini anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.10.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 1/1 (P) 2025 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës së Shqipërisë

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 127 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 86, pika 4, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); vendimi nr. 60, datë 16.10.2025, i Gjykatës Kushtetuese (*vendimi nr. 60/2025*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Holta Zaçaj, mori në shqyrtim kërkesën e Presidentit të Republikës së Shqipërisë (*Presidenti*) për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues emërtesë e tij, administroi dokumentacionin e nevojshëm, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj, në datën 10.3.2025, për shkak të përfundimit të afatit të kohëzgjatjes së tij. Në atë vendim Gjykata u ndal edhe në përmbajtjen e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, që bën fjalë për një situatë kalimtare dhe që ka për qëllim garantimin e përtëritjes së rregullt të përbërjes së saj. Sipas Gjykatës, kushtetutëbërësi në ekuilibrin midis parimit të qëndrueshmërisë në detyrë dhe atij të përtëritjes së saj i ka kushtuar vëmendje të veçantë këtij të fundit dhe nën këtë logjikë momenti i mbarimit të mandatit të gjyqtarit paraardhës duket se ka lidhje me kohëzgjatjen e qëndrimit në detyrë të gjyqtarit që e ka zëvendësuar atë, në veçanti për sa i përket momentit të mbarimit të kësaj kohëzgjatjeje. Për rrjedhojë, ajo arriti në përfundimin se data e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues në rastin konkret ishte data e deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai ka zëvendësuar në detyrë. Po kështu, Gjykata theksoi se hapja e procedurës për plotësimin e një vendi vakant duhet të fillojë vetëm pasi ajo të ketë deklaruar mbarimin e mandatit të anëtarit të saj dhe vetëm pasi Kryetari i saj të ketë njoftuar organin përkatës të emërtesës. Ndaj, në çdo rast kur një organ i emërtesës vlerëson se Gjykata nuk e ka ushtruar kompetencën e saj brenda afatit ligjor, ai duhet t'i drejtohet asaj, duke i kërkuar me shkrim ushtrimin e një kompetence të tillë (*shih vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

2. Në datën 30.1.2025, Presidenti i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke parashtruar, në thelb, se ai, në cilësinë e njërit prej tre organeve të emërtesës, është penguar në ushtrimin e kompetencës kushtetuese, për sa kohë që Gjykata nuk ka deklaruar mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues që është emërtesë e tij.

3. Gjykata, në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 60, datë 16.10.2025, vendosi të shqyrtojë veçmas kërkimin e Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, duke disponuar edhe se një kompetencë e tillë i përket Gjykatës dhe vetëm pas kësaj organi i emërtesës ushtron kompetencën e tij të emërimit/zgjedhjes të gjyqtarit kushtetues.

4. Për sa i përket themelit të asaj çështjeje, Gjykata u ndal në interpretimin e nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, për shkak se vlerësoi se paqartësia e krijuar lidhur me kohëzgjatjen e mandateve të gjyqtarëve kushtetues ka në dukje karakteristikat e një mosmarrëveshjeje kompetencash midis organeve të përfshira në procedurën e emërimit të gjyqtarëve kushtetues, ndaj bën të nevojshëm interpretimin përfundimtar të normave kushtetuese lidhur me ndërveprimin e parimeve kushtetuese të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën e saj dhe të kohëzgjatjes së mandatit të gjyqtarit kushtetues. Në përfundim, Gjykata interpretoi nenin 179, pika 3, të Kushtetutës si vijon: "*Qëllimi i dispozitës kushtetuese është garantimi i përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, parim i përcaktuar në nenin 125, pika 6, të Kushtetutës. Për këtë arsye, neni 179, pika 3, i Kushtetutës ka përcaktuar shkurtimin me më pak se 9 vjet të mandateve të dy gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, njëri deri në vitin 2025 dhe tjetri*

deri në vitin 2028. Për sa i përket "kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit" të gjyqtarëve të tjerë, kjo dispozitë kushtetuese i referohet nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, i cili ka përcaktuar skemën kohore të përtëritjes së përbërjes së Gjykatës Kushtetuese, duke parashikuar përtëritjen e parë me një të tretën në vitin 2025, përtëritjen e dytë me një të tretën në vitin 2028 dhe përtëritjen e tretë me një të tretën në vitin 2031. Fillimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese përgjatë këtij regjimi tranzitor përkon me datën e deklaruar nga Gjykata Kushtetuese të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ai zëvendëson.".

5. Bazuar në sa më sipër, Gjykata u mblodh për shqyrtimin e kërkimit të Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtares së saj, zonjës Sonila Bejtja.

II
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

6. Gjykata vëren se zonja Sonila Bejtja ka aplikuar si kandidate në procedurën e shpallur nga Presidenti për plotësimin e vendit vakant në Gjykatë, vakancë e parakohshme, të shpallur nga ai organ emërtese në datën 22.11.2019. Në përfundim të kësaj procedure, me dekretin nr. 11886, datë 28.12.2020, Presidenti ka dekretuar: "*Zonja Sonila Bejtja emërohet gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese*". Në datën 29.12.2020 zonja Sonila Bejtja ka bërë betimin përpara Presidentit dhe ka filluar detyrën.

7. Kjo vakancë e parakohshme është krijuar për shkak se zoti Besnik Muçi, i cili është emëruar gjyqtar i Gjykatës me dekretin nr. 11313, datë 15.10.2019, të Presidentit, është shkarkuar nga detyra me vendimin nr. 32, datë 21.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

8. Nga ana tjetër, zoti Besnik Muçi ka aplikuar si kandidat në procedurën e shpallur nga Presidenti për plotësimin e vendit vakant në Gjykatë, vakancë e plotë, e shpallur në datën 7.2.2018, për shkak të mbarimit të mandatit 9-vjeçar të gjyqtarit Sokol Berberi. Për sa i përket këtij të fundit, ai është emëruar gjyqtar i Gjykatës me dekretin e Presidentit nr. 5250, datë 4.4.2007, për të cilin, sipas parashikimeve kushtetuese dhe ligjore të zbatueshme në atë kohë, është dhënë pëlqimi me vendimin nr. 86, datë 16.4.2007, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*).

9. Gjykata vëren, fillimisht, bazuar në qëndrimin e saj në vendimin nr. 60, datë 16.10.2025, se mandati kushtetues i gjyqtares Sonila Bejtja përfshihet në "mandatet e tjera" që i përkasin regjimit tranzitor të mandateve të gjyqtarëve kushtetues të emëruar/zgjedhur pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016, kohëzgjatja e të cilave, sipas përmbajtjes së pikës 3, të nenit 179 të Kushtetutës, rregullohet sipas skemës kohore të përtëritjes sipas nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 dhe i përket përtëritjes së parë me një të tretën, e cila kryhet në vitin 2025. Për rrjedhojë, ky mandat mbaron në vitin 2025.

10. Për sa i takon përcaktimit të momentit kohor të mbarimit të këtij mandati kushtetues (dita dhe muaji), Gjykata vëren se edhe pse zoti Besnik Muçi, në mandatin kushtetues të të cilit ka hyrë si zëvendësuese gjyqtarja Sonila Bejtja, ka kandiduar dhe është emëruar për një mandat të plotë dhe ka filluar detyrën në datën 18.10.2019 (data e betimit përpara Presidentit), në rastin konkret nuk gjejnë zbatim përcaktimet e nenit 129 të Kushtetutës dhe nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, për fillimin dhe mbarimin e këtij mandati kushtetues, për sa kohë që ai, siç u përmend më sipër, i përket regjimit tranzitor për të cilin kushtetutëbërësi në pikën 3, të nenit 179 të Kushtetutës, me qëllim garantimin e përtëritjes së rregullt të përbërjes së Gjykatës, ka parashikuar një rregullim të ndryshëm nga rregulli i përgjithshëm i kohëqëndrimit në detyrë dhe mbarimit të mandatit. Referuar vendimit nr. 60, datë 16.10.2025, të Gjykatës fillimi i mandatit kushtetues që ushtron gjyqtarja Sonila Bejtja përkon me datën e deklaruar nga Gjykata të mbarimit të mandatit të gjyqtarit që ajo ka zëvendësuar, pra të gjyqtarit Sokol Berberi.

11. Lidhur me datën e fillimit dhe mbarimit të mandatit të gjyqtarit të zëvendësuar Sokol Berberi, sipas akteve shkresore rezulton se ai është emëruar me dekretin e Presidentit nr. 5250, datë 4.4.2007, për të cilin është dhënë pëlqimi me vendimin nr. 86, datë 16.4.2007, të Kuvendit. Gjykata vëren se në rastin konkret nuk ka një vendim të sajin për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit Sokol Berberi, ndërkohë që me shkresat nr. 101 prot. dhe nr. 101/1 prot., datë 25.3.2016, Gjykata i ka dërguar Presidentit dhe Kuvendit informacion për fillimin dhe mbarimin e mandatit të atij gjyqtari, nga të cilat rezulton se ai ka filluar detyrën në datën 25.4.2007, kur ka bërë betimin përpara Presidentit, për rrjedhojë data 25.4.2016 konsiderohet edhe si data e

mbarimit të mandatit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese.

12. Për sa më sipër, në situatën që mandati i gjyqtarit Sokol Berberi ka mbaruar në datën 25.4.2016 në po atë datë ka filluar edhe mandati kushtetues që ushtron gjyqtarja Sonila Bejtja, i cili, nga ana tjetër, konsiderohet se ka mbaruar në datën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë, pra në datën 25.4.2025.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 127, pika 2 dhe 179, pika 3, të Kushtetutës, si dhe neneve 8, pika 3, 9, pikat 2 e 3 dhe 86, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese, zonjës Sonila Bejtja, në datën 25.4.2025.
- Njoftimin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë si organi i emërtesës.
- Njoftimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi menjëherë.

Marrë më 24.10.2025.

Shpallur më 24.10.2025.

Kryetare (**kundër**): Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini

Anëtarë kundër: Genti Ibrahimi

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkesës së Presidentit me objekt "*Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese*", ne kemi qëndrim të kundërt me shumicës, pasi ky kërkim, i veçuar për shqyrtim nga kërkimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave dhe interpretimin përfundimtar të Kushtetutës, është i pabazuar dhe, si i tillë, duhej rrëzuar.

2. Në vlerësimin tonë ky vendim ishte i pritshëm dhe i paracaktuar që prej mënyrës në të cilën po kjo shumicë në vendimin nr. 60, datë 16.10.2025, ka interpretuar dispozitat kushtetuese lidhur me mënyrën e zbatimit të dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës, ku qartazi i ka dhënë epërsi parimit të përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ndaj një parimi tjetër po kushtetues, atij të kohëzgjatjes së mandatit, por duke mos marrë në konsideratë as parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike për sa kohë që gjyqtarët kushtetues në detyrë, pra edhe gjyqtarja Sonila Bejtja, ka kandiduar, ka pranuar dhe është emëruar si zëvendësuese në një mandat të plotë 9-vjeçar, gjë që as në atë moment dhe as gjatë ushtrimit të këtij mandati nuk është vënë asnjëherë në diskutim as nga organet e emërtesës, as nga ndonjë organ tjetër.

3. Pavarësisht qëllimit që ka pasur kushtetutëbërësi në miratimin e dispozitës kalimtare, nenit 179, pika 3, të Kushtetutës dhe në vijim ligjvënësi në miratimin e nenit 86, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, skema e përtëritjes përgjatë regjimit tranzitor nuk mund të ndërhyjë në një mandat të plotë të gjyqtarit kushtetues, duke e prekur ose shkurtuar atë. Mandati në këtë rast nuk përkthehet thjesht si koha gjatë të cilës ushtrohet një detyrë e caktuar, pra si një detaj procedural, por ai lidhet drejtpërdrejt me garancitë dhe parimet kushtetuese, përfshirë ato të pavarësisë së Gjykatës dhe patundshmërisë në detyrë të gjyqtarit kushtetues. Siç ka theksuar Gjykata, me qëllim që të përcaktohet nëse një organ është "i pavarur", ndër të tjera, duhet konsideruar mënyra e emërimit të anëtarëve të tij, si dhe kohëzgjatja e funksionit të tyre (*shih vendimin nr. 20, datë 9.7.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Garancia e kohëzgjatjes dhe paprekshmërisë së mandatit e mbron gjyqtarin nga ndikimet e forcave politike që mund të vijnë në pushtet. Vetëm një gjykatë e pavarur, së cilës i garantohet paprekshmëria e mandatit të anëtarëve të saj, mund të konsiderohet si një gjykatë që administron drejtësinë kushtetuese, në përputhje me parimet kushtetuese (*shih vendimin nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Këto garanci janë të tilla që duhet ta mbrojnë gjyqtarin jo vetëm nga faktorët e jashtëm, por edhe nga vetë kjo Gjykatë, që në çdo rast duhet të ndalojë çdo ndërhyrje ose presion të jashtëm ndaj gjyqtarëve të saj dhe, në ndryshim nga sa është vepruar konkretisht prej saj, duhet të garantojë paprekshmërinë e mandatit/qëndrimit në detyrë të gjyqtarit kushtetues përgjatë gjithë kohëzgjatjes së tij.

4. Parimi i pavarësisë nënkupton, gjithashtu, se gjyqtari, në momentin e emërimit, duhet të dijë kohëzgjatjen e këtij mandati, bazuar në rregullimet ligjore përkatëse dhe kjo kohëzgjatje nuk mund të lihet në diskrecion të organeve që e kanë emëruar/zgjedhur atë (*shih vendimet nr. 55, datë 27.7.2016; nr. 24, datë 9.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Mbi këtë qasje Gjykata, në vendimin nr. 84, datë 23.12.2024, për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares Holta Zaçaj, duke iu referuar akteve të njoftimit të vakancës nga organi i emërtesës - Gjykata e Lartë, njoftimit për rihapjen e procedurës së aplikimit, kërkesës për aplikim dhe konfirmimit të kandidaturës pas rishpalljes së kësaj vakance, ka vlerësuar se ajo gjyqtare ka shprehur vullnetin e saj për të kandiduar për pjesën e mbetur të mandatit që përfundon në muajin mars të vitit 2025. Në vlerësimin tonë nuk ka asnjë vlerë se çfarë vendi ka zënë ky argument në vendimmarrjen e Gjykatës, për sa kohë që ai ka përbërë bazën e arsyetimit dhe është i lidhur me mënyrën sesi është zbërthyer parimi i pavarësisë së gjyqtarit në jurisprudencën kushtetuese. Thënë kjo, në rastin konkret, shumica nuk është ndalur aspak në analizën e situatës konkrete, që është katërcipërisht e ndryshme, për sa kohë që, referuar akteve të njoftimit të vakancës së plotë nga organi i emërtesës – Presidenti, njoftimit të vakancës së pjesshme për plotësimin e vendit vakant të krijuar për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi, kërkesës për aplikim të këtij të fundit dhe të vetë kandidates Sonila Bejtja, sikundër të gjitha akteve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe vetë dekreteve të Presidentit për emërimin e tyre në detyrë, ajo gjyqtare ka pranuar dhe ka shprehur vullnetin për të hyrë në një mandat të plotë 9-vjeçar dhe në përfundim të procedurës është emëruar për një mandat të plotë 9-vjeçar. Në këtë kuptim, këto elemente e bëjnë qëndrimin e shumicës kontradiktor me qëndrimin e mëparshëm të saj.

5. Në vlerësimin tonë, në situatën aktuale, në të cilën qartazi skema e përtëritjes së pjesshme të Gjykatës ka dështuar të funksionojë për shkak të mënyrës dhe kohës së zbatimit të ndryshimeve kushtetuese, mënyra për të siguruar zbatimin e saj nuk është përmes ndërhyrjes së kësaj Gjykate, pra përmes shkurtimit dhe ndërprerjes së mandateve të disa gjyqtarëve të saj që janë në detyrë në regjimin, sipas saj, tranzitor. Gjykata nuk mund të ndërhynte për të zhbërë mosfunksionimin e skemës duke sjellë pasoja negative në drejtim të parimeve kushtetuese që duhet të mbroheshin prej saj, që është ai i shtetit të së drejtës dhe lidhur me të parimi i pavarësisë së gjyqtarit kushtetues, i sigurisë juridike, sikundër ai i barazisë në të drejta.

6. Edhe nëse do të pranonim se kjo çështje nuk do të kërkonte ndërhyrjen e kushtetutëbërësit, por të Gjykatës për interpretimin përfundimtar të normës kushtetuese, e vetmja mënyrë për të garantuar respektimin e parimeve kushtetuese do të ishte përmes zbatimit të skemës në mandatet vijuese, duke përcaktuar detyrimin e secilit organ emërtese, sipas kuotave të tij, që të shpallte në vijim mandate të pjesshme për kohën e nevojshme që do të garantonte në vijim përtëritjen e Gjykatës çdo tre vjet me një të tretën, çka do të garantonte edhe që çdo gjyqtar pasues të kandidonte dhe të pranonte të ushtronte detyrën për kohëzgjatjen e shpallur të mandatit dhe në asnjë rast duke prekur një mandat të dhënë si të plotë.

7. Në nenin 127 të Kushtetutës janë përcaktuar të vetmet shkaqe të lejueshme kushtetutshmërish për mbarimin e mandatit të gjyqtarit kushtetues, mes të cilave, shkronja "b" parashikon si të tillë përfundimin e mandatit 9-vjeçar. Për rrjedhojë, ne nuk jemi dakord as me konceptin e "mandatit kushtetues" të futur nga kjo shumicë, përmes të cilit synohet të krijohen koncepte të reja kushtetuese, që bien ndesh edhe me vetë normat kushtetuese dhe praktikën e kësaj Gjykate gjatë zbatimit të tyre. Kushtetuta e rregullon mandatin e gjyqtarit kushtetues në nenet 125 e vijues të saj dhe flet vetëm për një lloj mandati "*mandati i gjyqtarit kushtetues*", i cili në rastet kur është i plotë, siç është rasti i gjyqtarit Besnik Muçi, të cilin ka zëvendësuar gjyqtarja Sonila Bejtja, nënkupton qëndrimin në detyrë për 9 vjet, sipas nenit 125, pika 3, të Kushtetutës. Kjo kohëzgjatje në rastin konkret ka filluar nga dita e betimit të atij gjyqtari, sipas nenit 129 të Kushtetutës dhe do të përfundonte në ditën e njëjtë të atij muaji të vitit të nëntë. Për rrjedhojë, qëndrimi i shumicës dhe interpretimi se mandati fillon në ditën e deklarimit të mandatit kushtetues, e lidhur me datën e mbarimit të mandatit të gjyqtarit që zëvendësohet, ka zhbërë nenin 125, pika 3 dhe nenin 129 të Kushtetutës, duke asgjësuar betimin përpara Presidentit dhe dekretin si akt, si parakusht për fillimin e detyrës, e vetmja ngjarje me pasoja kushtetuese në fillimin dhe mbarimin e

mandatit/qëndrimit në detyrë për 9 vjet të gjyqtarit kushtetues.

8. Në vlerësimin tonë, për sa kohë që vetë dispozita tranzitore, neni 179, pika 3, i Kushtetutës nuk ka një parashikim të shprehur për përjashtimin e zbatimit të rregullave të përgjithshme për fillimin dhe mbarimin e mandatit/qëndrimit në detyrë të "gjyqtarëve të tjerë" kushtetues dhe as për kufizimin e mandateve të këtyre gjyqtarëve përgjatë regjimit tranzitor, kjo Gjykatë, në respekt edhe të parimit të vetëpërmbajtjes, nuk mund të bënte përmes interpretimit të saj atë që vetë kushtetutëbërësi nuk ka dashur ta bëjë. Parashikimi "*kohëzgjatjes së mandatit, sipas ligjit*", në nenin 179, pika 3, të Kushtetutës nuk mund të nënkuptojë anashkalimin e normave kushtetuese të zbatueshme si më sipër, për sa kohë që përmes normave me natyrë ligjore nuk mund të kufizohen ose interpretohen normat garantuese të nivelit kushtetues.

9. Siç u theksua edhe më sipër, mbrojtja e së drejtës së gjyqtarit për të ushtuar mandatin e tij të plotë përgjatë periudhës 9-vjeçare mbështetet në parimet kushtetuese të pavarësisë së Gjykatës dhe të vetë gjyqtarit, si dhe të patundshmërisë në detyrë, ndërkohë që ndërprerja e mandatit në mënyrë të parakohshme, pa pëlqimin e vetë gjyqtarit, mbështetet në shkaqe të tjera kushtetuese. Procesi i deklarimit të mbarimit të mandatit është deklarativ dhe gjatë tij verifikohet data e betimit të gjyqtarit dhe lidhur me të, data që i përket ditës së njëjtë të të njëjtit muaj të vitit të nëntë kalendarik, dhe vetëm në këtë rast angazhohet trupa e gjyqtarëve me një proces deklarativ të bazuar në verifikimin e vetëm këtyre fakteve. Mënyra e ushtrimit të kësaj kompetence nga Gjykata përbën një garanci tjetër për mbrojtjen e gjyqtarit nga interpretimi dhe ndërhyrja në ushtrimin e mandatit të tij nga vetë kjo Gjykatë ose gjyqtarët e saj përmes interpretimit, i cili nuk mund të ndërpresë një detyrë që ka filluar të ushtrohet sipas rregullave kushtetuese të zbatueshme në kohën e emërimit/zgjedhjes së gjyqtarit, të njohura dhe të pranuara prej vetë atij, organeve të emërtesës dhe atyre të përfshira në proces, ashtu dhe prej vetë kësaj Gjykate.

10. Nga ana tjetër, edhe Komisioni i Venecias ka vlerësuar se modeli kushtetues i miratuar në vitin 2016 është shumë kompleks dhe, në planin afatgjatë, është rekomanduar thjeshtimi i tij, në radhë të parë duke hequr rregullin e sekuencës. Sipas Komisionit të Venecias, kuotat e tre organeve të emërtesës mund të ruhen duke i caktuar automatikisht rinovimin e një mandati të njëjtit autoritet që ka emëruar gjyqtarin që largohet. Po sipas tij, vitet fikse të fillimit dhe mbarimit të mandateve 9-vjeçare duhet të hiqen dhe gjyqtarët kushtetues duhet të gëzojnë gjithmonë një mandat të plotë 9-vjeçar, edhe nëse janë zgjedhur me vonesë ose marrin një mandat që ka mbaruar përpara afatit (*shih paragrafin 107, të opinionit të Komisionit të Venecias nr. 978/2020 CDL-AD(2020)010, datë 19.6.2020, "Për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese*").

11. Për të gjitha argumentet si më sipër, kërkimi i Presidentit për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtares Sonila Bejtja është i pabazuar, ndaj duhej të ishte vendosur rrëzimi i tij.

Kryetare: Holta Zaçaj
Anëtar: Genti Ibrahimi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me vendimin nr. 3875, datë 18.6.2025, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Hasime Aliaj, e datëlindjes 1.2.1935, dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shtetasit Bilbil Aliaj.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/10/29 14:27:41 +02'00'
2897ef3e719242febe98c6fc287bfb272025102914
273230031

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)